VLERA

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI

Fletë Musinja
për Naim Frashërin
e pa dëgjuar më parë

PRISHTINË * NR.32 * TETOR 2020 * WWW.REVISTAVLERA.NET

Qerbelaja është....

Është legjendë e martirëve që u jep shembull të gjitha kombeve të shtypura në botë.

Është fitore që është arritur me gjak e liri.

Është mësim se si të luftohet e keqja dhe të ndërtohet e mira.

Është fjalë e vërtetë në fytyrë të tiranëve të padrejtë.

Është fushë e përgjakur në të cilën drejtësia kundërshtoi mizorinë.

Është vlerë humane dhe fetare.

Është mirësjellje, edukatë dhe morali më i lartë njerëzor.

Është pasimi më i mrekullueshëm sipas parimeve të Imam Husejnit.

Është disfatë e superfuqive kundër të drejtës e së vërtetës.

Është gjak që ujiti fushën e historisë duke i dhënë shembull njerëzisë.

Është çështje politike dhe devotshmërie shumë e rëndësishme.

Është thirrje në udhëzim me zemër të vërtetë e të sinqertë.

Është frymë që ringjalli fenë hyjnore për të mirën e njerëzisë.

Është triumf i arsyes mbi injorancën, i drejtësisë mbi tiraninë, i paqes mbi luftën.

Është simbol i trimave të cilët dolën ta mbrojnë të shtypurin, të Drejtën dhe të Vërtetën.

Është sacrificë dhe bindje ndaj një ideali të Shenjtë.

Është pavarësi, liri, drejtësi, unitet, tolerancë, barazi, sovranitet,

e mbi të gjitha jetë me dinjitet.

Mesazh nga poema " Qerbelaja" e Naim Frashërit.

Fjalë miradije dhe komentet **e lexuesve të VLERA-së**

Albenita Gjergjizi: Selam, Faleminderit që e paskeni vlerësuar komentin tim në postin tuaj, komplimenti i dhënë revistës suaj është realitet, është revistë ideale, populli ynë ka nevoje shume për revista të tilla edukative, prandaj thjesht e keni sevap që sado pak te kontribuoni në atë që më së shumti na duhet sot, në këtë kohë kur populli "bombardohet" me anti-vlera.

ABDULLAH KRASNIQI: E nderuara redaksi, revista VLERA më ka ra në duar dhe jam më se i lumtur që do të jem lexues i pandarë i VLERA-së gjersa sa të jem gjallë. Po e lexojë nëpër komente se juve disa njerëz ju fyejnë e ju nënçmojnë, por ju mos u ndalni sepse ata që flasin keq për VLERA-në dhe kryeredaktoren tuaj janë të pacipët, injorantët dhe se është normale këtyre t'u pengon aktiviteti edukativ. Ata me pa të padrejtë i japin kahje dhe vlerësim joreal siç janë në zemrën e tyre, por kjo gjë mos të ju shqetësoj fare, sepse ky lloj specie edhe profetëve të pamëkatë iu kane bërë "vërejtje" e këtë e dini mire.

Mendoj që ju znj. Ikballe , nuk nxirrni revistën vetëm sa për t'iu përmbajtur traditës të del çdo muaj, por e kalitni idenë që thjesht ta ngritni lartë atë ide në rëndësinë e të përmbajturit të moralit trashëgues të shkëlqyeshëm. Allahu ju ndihmoftë.

Selam shume unë ABDULLAH KRASNIQI

Prof. Teolog: Pleurat Hoxha. Motra Ikballe, e lus Allahun që të jeni mire. E-mail adresën tuaj e morra ne revistën e mbarë VLERA të cilën rregullisht e blej me kënaqësi ngase kemi shumë çka të lexojmë në të. Me ta thënë të drejtën po na mungojnë postimet tuaja në Facebook. InshaAllah muajin e ardhshëm mendoj të vij në panairin tradicional te librit në Prishtinë dhe dëshiroj të ju vizitoj në ato ambiente të bukura te Institutit Naim Frasheri, deri atëherë, selamun alejkum.

Idriz Nuhija Mirdita me fal a ka mundësi të më tregoni ku mund ta gjejë revistën VLERA dhe materiale tjera fetare që i përngjajnë përmbajtjes së VLERA-së. Unë jetoj në Maqedoni në qytetin e Tetovës, por mund të shkojë edhe në Shkup nëse atje keni librarin tuaj. pasi unë nuk jetojë në Tetovë.

Përgjigjja e redaksisë: I nderuari zotëri, Idriz ju faleminderit për interesimin tuaj dhe përkrahjen tuaj morale , pasi që ju treguat interesim, ne revistën VLERA do ta dërgojmë në Fondacionin Kulturor " GNOSA" në Tetovë dhe ju atje mund ta merrni edhe revistën VLERA edhe shumë libra materiale tjera fetare për të cilat ju treguat interesim .

Mexhid Çafleshi: E nderuara redaksi unë jam pensioner dhe 4 kopje të revistës VLERA më kanë ra në dorë nga një mik i imi, ju lutem të na kompletoni të gjitha numrat kopjet dhe na dërgoni me post . Pagesën do tua bëjë përmes postës apo mënyrën si e praktikoni. Ju lutemi të gjitha numrat paraprak dhe të ardhshëm.

Lexuesi nëpër komente:

- Jeni revistë me përmbajtje të veçantë ju urojmë suksese.
- Është hera e parë në jetë të e lexojë një revistë nga faqja e parë deri tek e fundit.
- Jeni të gjithanshëm, kombëtarë , fetarë , modern dhe shumë studiciozë. Ju lumtë.
- Perla diturish.
- E vetmja revistë që temat mund ti lexojë nga fillimi deri në fund.
- Nga çdo faqe e revistës mund të nxjerrësh mesazhe që të shtyjnë të mendosh tërë ditën dhe pak të bëjnë skeptikë për atë që kam besuar deri sot.

Doktrina e fesë

Në fenë islame dhe në veçanti në Kuranin e Madhëruar, historisë i është dhënë një rëndësi e madhe. Duhet theksuar se Islami nuk është doktrinë e njohjes së shoqërisë, as e filozofisë së historisë, po ashtu dhe Kurani Famëlartë nuk është libër shkencor, as filozofik dhe as historik, por është libër drejtimi për njerëzit, e në të njëjtën kohë mund të nxirren një numër i madh shkencash që janë përmendur në të.

Kur'ani dhe tërësia historike

Pikëpamja e Kuranit Famëlartë, në lidhje me parashikimin e së ardhmes së historisë së njerëzimit, është plotësisht e qartë. Sipas Kur'anit, në tokë do të mbretërojë rregulli dhe qetësia, paqja dhe mirëqenia, drejtësia dhe mirësia. Me vendosjen e një sistemi qeverisjeje të tillë, njerëzimin do ta mbulojë një lumturi dhe gëzim i papërshkrueshëm, ku premtimet e të gjithë engjëjve dhe ambasadorëve qiellorë në tokë do të veshin rrobat e veprimit. Madje, në pjesën e dytë të kësaj qeverie botërore, të gjitha dimensionet shpirtërore të njeriut do të zhvillohen plotësisht. Megjithëse na duhen vite dhe shekuj të gjatë për të arritur deri atje, duhet theksuar se e gjithë historia njerëzore, që nga gjeneza dhe deri te arritja e një qeverie qiellore për të gjithë botën, është vetëm një hyrje e vogël përballë pjesës tjetër që mbetet pas kësaj qeverie.

"Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë të mbrapshtët."

(En-Nur: 55)

Gjithashtu, edhe në ajete të tjera, si dhe në ajetin e mëposhtëm, Zoti thotë:

"Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë."

(En-Enbia: 105).

Nuk ka asnjë dyshim se këto ajete nuk janë fjalime shkencore, që janë nxjerrë mbi bazën e përvojës ose mbi bazën e parashikimit shkencor, sepse, siç e theksuam edhe në fillim të kapitullit, të gjitha parashikimet shkencore janë të kushtëzuara dhe jo të prera. Në Kur'an kemi të bëjmë me një parashikim të prerë dhe të padiskutueshëm, të bazuar mbi dije dhe njohje qiellore dhe profetike dhe jo mbi bazën e ndonjë studimi shkencor mbi historinë.

Kur'ani dhe elemente përbërës të historisë

Shumë ajete kur'anore tregojnë momente të ndryshme të historisë. Kur'ani, mbi bazën e ligjeve qiellore, ka ndjekur hap pas hapi pjesë të ndryshme të historisë, ngjarje të të parëve tanë dhe ndryshimet që kanë pësuar ata. Në disa

ajete bëhet fjalë për gjendjen dhe fatin e popujve, që, për arsye të ngjashmërisë së pozicionit që kanë pasur, kanë përfunduar në një fat të përbashkët.

"Eh, sa e sa fshatra e qytete i kemi zhdukur Ne, sepse banorët e tyre bënin jetë të shfrenuar! Ja tek janë shtëpitë e tyre, të cilat janë banuar pas tyre fare pak ose aspak. Jemi Ne trashëgimtarët e fundit."

(El-Kasas: 58)39

Në shumë ajete të tjera, paralajmërohet për kushtet e nevojshme dhe të mjaftueshme, për ngritjen dhe rënien e popujve dhe shoqërive, duke marrë si shembull të kaluarën. Për këtë arsye, Kur'ani e konsideron historinë mësim dhe jep udhëzime mbi bazën e saj.

"Para jush kanë kaluar shumë shembuj (popujsh nga ndjekësit e profetëve që iu ndodhi ajo që po ju ndodh edhe ju). Prandaj udhëtoni nëpër botë dhe shihni si ishte fundi i atyre që i përgënjeshtruan profetët."

(Al- Imran: 137)

Duke u bazuar në studimin e së kaluarës, Islami, historinë e prezanton si burim dijesh dhe njohjesh. Duhet mësuar dhe marrë shembull nga e kaluara, në mënyrë që të zgjedhim një rrugë të drejtë në të ardhmen.

Ligjet familjare në islam

Një nga veçoritë e karakterit të njeriut është krijimi i familjes. Jeta familjare e njeriut është plotësisht natyrore dhe jo e paracaktuar, domethënë, e vendosur, që në krijimin e tij, të ketë familje dhe fëmijë. Ngjarjet historike na tregojnë se njeriu, në të gjitha periudhat kohore, ka pasur jetë familjare, ku burri dhe gruaja asnjëherë nuk kanë jetuar veç e veç. Madje edhe në periudhën e njerëzve të egër, që njihet si periudha më e largët, po kështu ishte.

Roli i pazëvendësueshëm i familjes

Familja ka peshë të rëndësishme dhe vitale në jetën e njeriut. Në të kaluarën ju jeni njohur dhe i keni ndeshur këto rezultate, që në këtë pjesë ne nuk do t'i përmendim, vetëm se do të mjaftohemi me analizën e disa pikave të rëndësishme në këtë fushë.

• Lumturia dhe mirëqenia e një shoqërie varet nga ligje të sakta dhe të ngrohta familjare. Thyerja e ligjeve familjare do të shoqërohet me çrregullime të mëdha në jetën shoqërore. Me fjalë të tjera, lumturia e çdo shoqërie farkëtohet në familjet përbërëse, ku shoqëri të sakta kanë nevojë për familje të sakta.

• Njeriu, që në fëmijëri, duhet të njihet me rrugën e drejtë të jetës, ku vlerat njerëzore të rriten dhe të zhvillohen në mënyrë natyrore. Transmetimi i vlerave njerëzore dhe kulturore në çdo shoqëri i përket në radhë të parë familjes. Në shoqëritë e përbëra, nga familje të paqëndrueshme ose që nuk janë në gjendje të kryejnë detyrat përkatëse, lidhjet kulturore, shoqërore, njerëzore etj, midis brezit të ri dhe brezit të vjetër dëmtohen jashtë mase, madje edhe shkëputen nga njëri-tjetri, ku si rezultat, brezi i ri mbetet pa bazat themelore të vlerave shoqërore. Ky lloj brezi nuk mund ta zotërojë dhe ta transmetojë identitetin kulturor të tij dhe në luhatjet e ndryshme shoqërore, kulturore etj, rrezikon të humbasë vlerat e veta deri në zhdukjen e plotë.

• Familja, në vetvete, është një ligj për të rritur dhe zhvilluar brezin e ri. Në bazë të këtij ligji, brezi i ri, nën rrezatimin e dashurisë familjare, duhet të zhvillojë ndjenjat dhe vlerat e tij të larta dhe të njihet me dashurinë njerëzore, duke hedhur në këtë mënyrë farat e mirësisë në karakterin e tij. Duhet theksuar se ndjenja e dashurisë tek njeriu është një nga investimet më të mëdha jo vetëm për jetën e tij, por edhe për jetën shoqërore. Në qoftë se njeriu, që në fillimet e tij, familjarizohet me të tilla ndjenja, edhe më vonë do të jetë gjithmonë në kërkim të këtyre ndjenjave dhe asnjëherë nuk do t'i nënvleftësojë ato. Ai shumë shpejt do të njohë sakrificën, e shikon lumturinë e tij tek lumturitë e të tjerëve, e krahason shoqërinë me ambientin e tij familjar. Me fjalë të tjera, ai njihet plotë-

sisht me vlerat njerëzore, duke përfituar kështu dashurinë njerëzore, si dhe shumë investime të tjera në botën e tij shpirtërore, duke rritur dhe zhvilluar gjerësisht të gjitha ndjenjat e fshehura shpirtërore.

• Njohja e detyruar e detyrave familjare

• Ai që ka vendosur të krijojë familje, për të arritur këtë qëllim, duhet të ketë parasysh se organizmi i familjes, ashtu si dhe shumë organizma të tjera shoqërore, ka një bosht drejtimi, ose me fjalë të tjera, është e përbërë nga principe themelore. Vetëm në bazë të njohjes së këtij boshti dhe kryerjen me korrektësi të detyrimeve që rrjedhin nga principet mund të arrihet në qëllimin e duhur. Mosnjohja e këtij boshti bëhet shkak i dëmtimeve të pa kompensueshme në strukturën e familjes, madje gruaja dhe burri, së bashku me fëmijët e tyre, mund të mos arrijnë lumturinë e kërkuar.

Arsyeja, që disa familje janë në gjendje kritike dhe të mbuluara me keqkuptime është se çifti i ri, përpara se të hedhë hapin për krijimin e familjes, nuk ka pasur njohjen e duhur dhe ka qenë fare i papërgatitur në lidhje me të drejtat dhe detyrat familjare, duke e konsideruar si një hap të parëndësishëm në jetë, por më vonë, me kalimin e një kohe relativisht të shkurtër, e kuptojnë se në çfarë përmasash ka qenë gabimi i tyre.

Ajo që e bën me tepër të detyrueshëm njohjen e sistemit familjar dhe i rrit rëndësinë kësaj njohjeje është fakti se ekzistojnë një numër i madh rrugësh dhe mënyrash të gabuara në këtë mes.

Fatkeqësisht, që në fillimet e krijimit të familjes, lloje të ndryshme traditash dhe zakonesh ose këndvështrime të gabuara, të bazuara në injorancë, mendjemadhësi, mosnjohje të principeve themelore etj, lëshojnë rrënjë, duke u bërë pengesë e pakapërcyeshme për çiftin e ri, në rrugën e tij drejt lumturisë. Madje, disa nga këto doke dhe zakone të gabuara bëhen shkak që shumë vajza dhe djem të mos krijojnë familje.

Ata që ndikohen me tepër nga bota materiale, pa u menduar për të tjerët, jo vetëm që ndjekin këto rrugë të gabuara, por pak nga pak u shtojnë diçka amplitudës së këtyre zakoneve. Tek disa të tjerë, këto dëmtime dhe humbje të rënda në jetën e tyre familjare vijnë si rezultat i këndvështrimeve të gabuara që bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë në lidhje me njëri-tjetrin dhe me pozicionin e tyre në familje.

Në këtë kontekst, do të përpiqemi që lexuesi të njihet më tepër me disa nga ligjet themelore në këtë fushë dhe të kuptojë rëndësinë e problemit në fjalë, në mënyrë që me njohuri të mjaftueshme dhe të sakta, në këtë shkallë të jetës, sa e rëndësishme, po aq dhe serioze, të hedhë hapin e duhur.

Natyra dhe pozicioni i familjes në islam

Po të hedhim një sy mbi mësimet islame, do të kuptojmë se problemi i martesës, së bashku me etapat dhe të vërtetat që lidhen me të, zë një vend të rëndësishëm në Islam. Në kundërshtim të plotë me disa nga doktrinat e tjera, që sugjerojnë beqarllëkun si zgjidhje të problemeve njerëzore, Islami, martesën e konsideron të shenjtë dhe e ndalon filozofinë e të qenit beqar.

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimi i All-llahut qoftë mbi të), ka thënë:

"Asnjë strukturë në Islam nuk është ndërtuar dot në mënyrë që pranë Zotit të jetë me e dashur se martesa."

Në fjalime të tjera thuhet: "Martesa është nga rregullat e mia dhe çdokush që do ta shkelë atë, nuk është nga të mitë." Nga ana tjetër, Islami, detyrat dhe të drejtat e gruas, burrit, dhe fëmijëve në jetën familjare i ka shprehur në mënyrë të përmbledhur dhe të renditura mirë, që njihen si sistemi i të drejtave familjare në Islam. Ky sistem është krijuar mbi një bazë të veçantë, ku për një shpjegim më të thellë rreth tij duhet një studim i mirëfilltë.

Pikëpamja islame në lidhje me të drejtat në familje.
Islami, në lidhje me të drejtat familjare të burrit dhe gruas, ndjek një filozofi të veçantë, e cila, sigurisht, në lidhje me jetën e sotme, ndryshon me atë të jetës së katërmbëdhjetë shekujve më parë.

Islami nuk ka përcaktuar të drejta dhe detyra të njëjta midis burrit dhe gruas. Por në të njëjtën kohë, nga pikëpamja e të drejtave njerëzore, burrin dhe gruan i njeh të barabartë. Pra, Islami pranon barazinë midis burrit dhe gruas në tërësi dhe mohon të drejta dhe detyra të barabarta për secilin. Për ta kuptuar më mirë këtë pikë duhet pasur parasysh se barazia në këtë rast është me kuptimin e barazisë jo identike. Le të marrim një shembull: Babai i disa fëmijëve zotëron një pasuri, të përbërë nga toka bujqësore, zyra tregtie, kompani ndërtimi, si dhe biznese humanitare. Këtë

pasuri ai e ndan në mënyrë të barabartë midis fëmijëve të tij, mbi bazën e njohjes që ai ka për aftësitë e ndryshme të fëmijëve të tij. Fëmijës së parë i jep tokën bujqësore, duke qenë i bindur në dhuntitë që ky fëmijë ka për bujqësinë, krahasuar me fëmijët e tjerë; fëmijës së dytë i jep zyrat e tregtisë, pasi edhe për këtë ka bindje të plotë dhe kështu me radhë e ndan pasurinë e tij, duke marrë në konsideratë karakterin dhe fushat ku fëmijët e tij kanë talent. Kështu që babai e ndau pasurinë e tij në mënyrë të barabartë midis fëmijëve, por jo në mënyrë identike.

Pra, ai ruajti barazinë midis fëmijëve, duke preferuar një ndarje më të vlefshme mbi bazën e prirjeve të fëmijëve të tij. Kjo lloj barazie mund të krahasohet me sasinë me cilësi të ndryshme. Po kështu, edhe Islami, barazinë totale midis burrit dhe gruas e ka ruajtur dhe nuk i jep asnjërit prej tyre prioritet mbi tjetrin, duke mos pranuar barazinë identike në të drejta dhe detyra midis tyre. Këtu lind pyetja: Përse Islami nuk i ka përcaktuar të drejtat dhe detyrat e burrit dhe të gruas në të gjitha rastet e mundshme? Si do të ishte më mirë, që të drejtat dhe detyrat e burrit, në lidhje me gruan të ishin të barabarta identike apo të ishin të barabarta dhe jo identike?
Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve duhet të trajtojmë tri çështje: 1 - Mendimin islam, në lidhje me pozicionin njerëzor të gruas; 2 - Për çfarë qëllimesh janë ndryshimet fizike që ekzistojnë në krijimin e burrit dhe të gruas? A mundet që këto ndryshime të përcaktojnë edhe barazinë jo identike në të drejta dhe detyra midis burrit dhe gruas? 3- Mbi ç'filozofi bazohen ndryshimet në të drejta dhe detyrat, që ekzistojnë midis burrit dhe gruas në islam? A është ende në fuqi kjo filozofi?

Vazhdon...

Lindja e Muhammedit *dhe vitet e hershme të jetës së tij*

Para profecisë.
I pajisur me një mendje të fortë dhe me një shije të rafinuar, i mbyllur në vete dhe meditativ, ai e jetoi pjesën më të madhe të jetës së tij brenda vetes dhe në përsiatjet e zemrës së tij gjeti zëvendësim për orët e tëra që burrat e tjerë i kalonin në argëtime dhe ahengje. Karakteri i drejtë dhe sjellja fisnike e këtij të riu i fituan lëvdatat e bashkëqytetarëve të tij, të cilët e quanin "El-Emin" (i besueshmi). I respektuar dhe i nderuar, Muhammedi jetoi një jetë të qetë dhe të tërhequr në familjen e Ebu Talibit.

Abdullahu ishte djali më i dashur i Abd'ul-Muttalibit. Kur i mbushi të shtatëmbëdhjetat, ai u martua me Aminen, një grua fisnike nga Jethribi, qyteti në veri të Mekkes. Megjithatë, atij nuk i ishte shkruar të jetonte gjatë dhe vdiq vetëm shtatë muaj pas martesës së tij. Muhammedi, i Dërguari i Zotit, ishte një fëmijë i lindur pas vdekjes së të atit. Shejh Muhammed el-Khidhri Buck, profesor i historisë islame në Universitetin Egjiptian në Kairo, thotë: Ai (Muhammedi) u lind në shtëpinë e xhaxhait të tij Ebu Talibit, në "distriktin" e Hashimitëve në Mekke, në ditën e dymbëdhjetë të muajit Rebbi el-Evvel(muaji i tretë) të "vitit të elefantit", një datë e cila sipas llogaritjeve është 8 Qershori i vitit 570 pas Krishtit. Mamia e tij ishte nëna e Abdurrahman ibn Auf-it. Nëna e tij Amineja, i dërgoi sihariqe Abdul Muttalibit, i cili erdhi menjëherë, e mori në krahë foshnjen dhe e quajti Muhammed.

Hiseja *trashëgimia e Profetit*

Hiseja e Muhammedit në trashëgiminë e të atit ishte një robëreshë e quajtur Umm Ejmen, pesë deve dhe dhjetë dele. Ky është një vërtetim se profetët mund të trashëgonin pasuri dhe nëse mund të trashëgonin atëherë do të thoshte se edhe mund t'u linin fëmijëve të tyre si trashëgim. Të qenit profet nuk e pengon njeriun nga të trashëguarit e pasurisë së tij dhe nuk i pengon fëmijët e tij të trashëgojnë nga ai. Kjo çështje mund të duket pa ndonjë lidhje me këtë temë, mirëpo nuk është e tillë. Muhammedi, profeti i Islamit (paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij), ia kishte falur të bijës, Fatimesë, tokat e Fedekut. Por kur vdiq profeti, Ebu Bekri (Kalifi i parë)

dhe Umari (Kalifi i dytë dhe këshilltari i të parit) e konfiskuan këtë pronë me pretendimin se profetët nuk u lënë trashëgimi fëmijëve të tyre dhe se gjithçka që ata lënë pas i takon shoqërisë islame dhe jo pasardhësve. Ky ishte një dënim i çuditshëm që duhej ta paguante djali ose vajza e një profeti. Secili njeri tjetër në shoqërinë islame kishte të drejtë të trashëgonte pasuri nga i ati përveç të bijës të të Dërguarit të Zotit, Muhammedit.

Zakoni i largimit të foshnjës nga nëna

Ekzistonte një traditë në mesin e arabëve, sipas të cilës ata i dërgonin fëmijët e tyre në shkretëtirë për t'i kaluar vitet e hershme të fëmijërisë në një klimë që ishte më e shëndetshme se ajo e Mekkes. Falë kësaj, fëmijët bëheshin më të shëndetshëm dhe e thithnin ajrin e pastër të shkretëtirës, i cili ishte më i shëndetshëm se klima aspak e këndshme e qytetit.

Një tjetër arsye e dërgimit të fëmijëve në shkretëtirë ishte fakti se arabët ishin mjeshtër të gojëtarisë dhe puristë të skajshëm kur bëhej fjalë për gjuhën. Ata e adhuronin gjuhën arabe me fjalët e saja me ato nuanca të ndryshme kuptimore dhe krenoheshin mjaft me gojëtarinë e tyre. Madje shumë shpesh, klasat aristokrate të Mekkes e mbështesnin autoritetin e tyre pikërisht në fuqinë retorike. Mekkeja ishte vendtakimi i karvanëve dhe si e tillë, arabishtja e saj nuk kishte arritur ta ruajë pastërtinë e duhur. Aristokratët arabë nuk dëshironin që fëmijët e tyre ta flisnin atë gjuhë "të rrugës" dhe për këtë i dërgonin në shkretëtirë, për ta mësuar gjuhën e pastër të shkretëtirës. Për këtë arsye, fëmijët e tyre largoheshin nga Mekkeja në vitet e hershme të fëmijërisë dhe me këtë mbroheshin nga ndikimet kulturore të këtij fenomeni.

Amineja ia dha Halimes djalin e saj Muhammedin. Halimeja i takonte fisit Esad që jetonte në lindje të Mekkes. Muhammedi i kaloi katër vitet e para të jetës së tij në shkretëtirë, nën kujdesin e Halimes. Sipas historisë, ajo e ktheu atë në Mekke në vitin e pestë të jetës së tij.

Muhamedi dhe përkujdesia e gjyshit

Muhammedi ishte vetëm gjashtë vjeç kur i vdiq e ëma Amineja. Atëherë ai mbeti nën përkujdesjen e gjyshit të tij Abd'ul-Muttalibit. Por vetëm pas dy vjetësh, edhe ky i fundit do të vdiste.

Pak përpara vdekjes së tij, Abd'ul-Muttalibi i thirri të gjithë djemtë dhe u tha se do t'u linte dy amanete: njëri ishte prijësia e Hashimitëve dhe i dyti ishte Muhammedi, djali i Abdullahut, nipi i tyre jetim që asokohe i kishte mbushur tetë vjet. Pastaj i pyeti se cili prej tyre do të donte ta trashëgonte autoritetin e tij dhe të kujdesej njëkohësisht edhe për fëmijën, i cili i kishte humbur të dy prindërit. Pjesa më e madhe e djemve të tij kishin shumë dëshirë t'ia zinin vendin si prijës i fisit por asnjëri nuk dëshironte ta merrte përsipër përkujdesjen e Muhammedit.

Teksa Abd'ul-Muttalibi i vështronte një nga një dhe mendonte për të ardhmen e fëmijës, një heshtje vrasëse ra mbi të gjithë. Por nuk zgjati shumë. Ebu Talibi, njëri nga djemtë e tij, bëri një hap para dhe tha se ai kishte dëshirë ta merrte jetimin e të vëllait Abdullahut dhe se nuk dëshironte ta trashëgonte pasurinë dhe autoritetin e Abdul Muttalibit.

Deklarata e Ebu Talibit e zgjodhi problemin e Muhammedit. Abd'ul-Muttalibi jo vetëm që e bëri atë kujdestar të Muhammedit por njëkohësisht edhe prijës të familjes së Hashimitëve.

Në shtratin e vdekjes, Abd'ul-Muttalibi shpalli se djali i tij Ebu Talibi do të ishte kujdestar i Muhammedit dhe prijësi i ri i Hashimitëve. Pastaj u urdhëroi të tjerëve që ta pranonin Ebu Talibin si prijës, gjë që e bënë të gjithë pa kundërshtim.

Prijësi i Luginës

Historia e vërtetoi saktësinë e vendimit të Abd'ul-Muttalibit. Djali dhe trashëgimtari i tij Ebu Talibi i plotësoi në mënyrën mëa të denjë të dyja detyrat.

Sir John Glubb:

Në vitin 578, Abdul Muttalibi vdiq. Përpara vdekjes së tij, ai ia la Ebu Talibit përgjegjësinë e përkujdesjes për Muhammedin. Abdullahu, babai i Muhammedit, ishte vëllai i Ebu Talibit nga e njëjta nënë. Siç dihet, djemtë e tjerë të Abd'ul-Muttalibit ishin nga gratë e tjera të tij ("Jeta dhe koha e Muhammedit", botuar 1970).

Ebu Talibi dhe e shoqja ishin krenarë dhe të lumtur që Muhammedi erdhi në familjen e tyre. Ata nuk e pranuan Muhammedin vetëm në shtëpinë e tyre por edhe në zemër, duke e dashur më tepër se fëmijët që i kishin.

Kush ishte Ebu Talibi

Ebu Talibi ishte një njeri me dinjitet dhe autoritet të lartë. Gjatë periudhës në të cilën ishte prijës i Hashimitëve, ai i mbajti titujt "Zotëri i Kurejshëve" dhe "Prijësi i luginës". Njësoj si pjesëtarët e tjerë të fisit të tij, edhe ai merrej me tregti. Karvanët e tij udhëtonin drejt Sirisë dhe Jemenit.

Çdo vit karvanët e Ebu Talibit largoheshin nga Mekkeja për në drejtime të ndryshme. Ndonjëherë edhe ai vetë nisej bashkë me ta për ta mbikëqyrur shitjen dhe për t'i ndjekur çmimet e mallrave në tregjet e huaja. Përcillet se Muhammedi, kur ishte vetëm dymbëd hjetë vjeç, e shoqëroi xhaxhain e tij në njërin nga këto udhëtime. Që në moshë të re Muhammedi krijoi emër si një njeri i drejtë dhe me gjykim të shëndoshë. Ngase në atë kohë nuk ekzistonin bankat ku mund të depozitoheshin gjërat me vlerë, Muhammedi u bë "banka" e mekkasve. Atij ia sillnin paratë, xhevahirët dhe sendet e tjera me vlerë dhe ai u kthente kurdo që të dëshironin t'i merrnin. Atë e quanin "Emin" (i besueshmi) dhe "Sadik" (i sinqerti).

Sir William Muir

I pajisur me një mendje të fortë dhe me një shije të rafinuar, i mbyllur në vete dhe meditativ, ai (Muhammedi) e jetoi pjesën më të madhe të jetës së tij brenda vetes dhe në përsiatjet e zemrës së tij gjeti zëvendësim për orët e tëra që burrat e tjerë i kalonin në argëtime dhe ahengje. Karakteri i drejtë dhe sjellja fisnike e këtij të riu i fituan lëvdatat e bashkëqytetarëve të tij, të cilët e quanin "El-Emin" (i besueshmi). I respektuar dhe i nderuar, Muhammedi jetoi një jetë të qetë dhe të tërhequr në familjen e Ebu Talibit...

("Jeta e Muhammedit", fq. 20; botuar 1877).

Kur Muhammedi ishte njëzet vjeç, u bë një betejë ndërmjet fisit Kurejsh dhe fisit Havazin. Ndonëse Muhammedi ishte i pranishëm, ai nuk mori pjesë në luftime. Nuk e vrau dhe as e plagosi dikë, duke e treguar që në atë kohë urrejtjen që kishte ndaj gjakderdhjes. Thuhet se në këtë betejë ai i mblidhte nga toka shigjetat e armiqve dhe ua jepte xhaxhallarëve të tij për të qëlluar. Pas disa vitesh Muhammedi u bë pjesë e "Lidhjes së të virtytshmive". Siç përmendëm edhe më sipër, kjo lidhje ishte betuar që t'i mbronte të dobëtit, t'i kundërshtonte tiranët e mizorët dhe t'i sillte fund diskriminimit në të gjitha format e tij. Vlen të përmendet se ishte pikërisht familja e Hashimitëve (të cilës i takonte Muhammedi) që e themeloi këtë lidhje. Ishte vallë kjo vetëm një rastësi? Nuk ka mundësi të gjendet përgjigja e kësaj pyetjeje. Por ishin pikërisht Hashimitët ata që i shpallën luftë pabarazisë dhe padrejtësisë. Ata e bënë të qartë se nuk do t'i toleronin krimet e të fuqishmit kundër të dobëtit dhe se nuk do të lejonin që të varfrit e Mekkes të shfrytëzoheshin nga pasanikët e Kurejshit. Vetëm pas disa viteve, Muhammedi do të bëhej nismëtari i një programi të ri shoqëror, elementi ekonomik i të cilit do të kishte për qëllim pikërisht shkatërrimin e këtij shfrytëzimi të padrejtë. Ai do t'ia merrte Kurejshit privilegjet dhe "të drejtën" e tyre për t'i shfrytëzuar varfanjakët dhe të dobëtit.

Montgomery Watt

"Lidhja e të virtytshmive" duket se ka pasur një ndikim të rëndësishëm në jetën e Mekkes dhe se ka qenë e drejtuar pikërisht kundër personave dhe politikave, me të cilat Muhammedi do të përballej në të ardhmen. Në veçanti fisi i tij i Hashimitëve kishte një rol qendror në këtë lidhje.
("Muhammedi: Profet dhe burrë shteti", botuar 1961).

Ritregim i historisë së Islamit dhe myslimanëve,
Sejjid Ali Asghar Razvi

Letra e Imam Aliut
për guvernatorin e tij Malik el-Eshter

Historiani Mes'udi e pranon që Imam Aliu ishte autor i jo më pak se 480 traktateve, ligjëratave dhe korrespodencave me tema të ndryshme lidhur me filozofinë, fenë, jurisprudencën dhe politikën, të mbledhura nga Zaid Ibn Wahab gjatë kohës kur ka jetuar vetë Imami. Këto kontribute çmohen shumë si për përmbajtjen e tyre ashtu edhe për vlerën e tyre të brendshme letrare, kështu që disa veprat e tij madhore janë bërë tema studimi në kolegje dhe universitete islame. Reputacioni i Imam Aliut duket të jetë bërë i njohur në Evropë në periudhën e renesansës ngase Edward Powcock (1604-91), profesor në Universitetin e Oksfordit, në vitin 1639 kishte mbajtur një seri ligjëratash për "Retorikën" e Imamit dhe ishte ai që publikoi përkthimin e parë në anglisht të "Thënieve" të Imamit.

Këtu e paraqesim letrën e njohur këshilluese të Imam Aliut, në kohën kur ai ishte halif, drejtuar guvernatorit të Egjiptit, Malik el-Eshter, e cila bazohet në përkthimin e Rasheed Turabi. Letrën, sipas Fehrist-i-Tusi (fq. 33), e ka kopjuar për herë të parë Asbagh bin Nabata në kohën sa ishte gjallë vetë Imam Aliu dhe më vonë është riprodhuar nga shkollarët e ndryshëm islam të cilët i janë referuar kësaj letre në shkrimet e tyre; kryesorët prej tyre kanë qenë Nasr ibn Mazahim (148 A.H.), Jahiz Basari (255 A.H.), Syed Razi (404 A.H.), Ibn-i-Abil Hidaid dhe Allama Mustafa Bek Najib, shkollari i mirënjohur egjiptian i cili ende jeton. Ky i fundit, e konsideroi këtë letër "si udhëzues themelor për administratën islamike".

Letra e halifit Ali drejtuar Malik l-Eshter-it, Thesari më i madh

Po të njoftoj, o Malik, se po të dërgoj si Guvernator në një vend i cili në të kaluarën ka përjetuar pushtetin e drejtë si dhe të padrejtë. Njerëzit do t'i vështrojnë me vëmendje dhe sy kritik veprimet e tua, ashtu siç i ke vështruar ti veprimet e atyre para teje, dhe do të flasin për ty sikurse ke folur ti për të tjerët. Është fakt që njerëzit flasin mirë vetë për ata që bëjnë vepra të mira. Ata janë dëshmi për veprimet e tua. Prandaj, thesari më i madh që mund ta lakmosh është thesari i veprave të mira. Mbaji dëshirat e tua nën kontroll dhe mos i lejo vetës ato gjëra që i ke të ndaluara, sepse, me anë të vetëpërmbajtjes, do të jesh në gjendje të dallosh çka është mirë për popullin e çka jo.

Krijo në zemrën tënde ndjenjën e dashurisë për njerëzit e tu dhe le të jetë ajo burim i mirësisë dhe bekim për ata. Mos u sjell me ata si barbar dhe mos e përvetëso për veten atë që i takon popullit. Mbaje në mend që njerëzit i takojnë dy kategorive, ose se i ke vëllezër të fesë ose i ke vëllezër të sojit tënd. Ata mund të shfaqin dobësi dhe janë të prirur të bëjnë gabime. Disa prej tyre edhe do të bëjnë gabime. Por fali ata ashtu siç do të doje që Zoti të të falte ty. Mbaje në mend që ti je caktuar mbi ta, ashtu siç jam caktuar unë mbi ty. Por është Zoti ai që është mbi atë që ty ta ka dhënë pozitën e guvernatorit në mënyrë që të kujdesesh për ata që janë nën ty. Dhe do të gjykohesh për ato që bën për popullin.

Malik el-Eshter

Mos e kundërshto Zotin, sepse ti as nuk ke forcë të mbrohesh nga pakënaqësia e Tij, as nuk mund ta përjashtosh veten nga rrethi e Tij i mëshirës dhe faljes. Mos u pendo për ndonjë falje që e ke bërë, e as mos u gëzo për ndonjë dënim që ia ke caktuar dikujt. Mos u nis nga zemërimi se asnjë e mirë nuk të del.

Mos thuaj: "Unë jam sundimtari dhe diktatori juaj dhe ju duhet t'i bindeni urdhërave të mi" ngase ky lloj qëndrimi do ta korruptojë zemrën tënde, do ta dobësojë besimin tënd ndaj fesë dhe do të shkaktojë rrëmujë në shtet. Nëse ngazëllehesh nga pushteti apo krijon në mendjen tënde qoftë edhe pak mendjemadhësi dhe arrogancë, atëherë mendoje fuqinë dhe madhështinë e pushtetit hyjnor të universit ndaj të cilit nuk ke absolutisht asnjë kontroll. Kjo ia kthen sensin e baraspeshës intelegjencës sate kokëforte dhe ta jep sensin e qetësisë dhe dashamirësisë. Kujdes! Kurrë mos e kundërshto madhështinë dhe fisnikërinë e Zotit dhe kurrë mos e imito plotfuqishmërinë e Tij; ngase Zoti e ka nënshtruar çdo person që është rebeluar kundër Tij dhe çdo tiran të njerëzimit.

Respektoje Zotin dhe njerëzit përmes veprave tuaja dhe gjithashtu bindi shokët dhe të afërmit tuaj të veprojnë njëjtë. Përndryshe do t'i shkaktosh padrejtësi edhe vetës edhe njerëzimit. Sepse ashtu, edhe Zoti edhe njerëzit do të bëhen armiqët e tu. Nuk ka shpëtim askund për atë person i cili Zotin e kthen në armikun e vetë. Ai do të konsiderohet që është në luftë me Zotin derisa të pendohet dhe të kërkojë falje. Asgjë nuk e privon njeriun nga bekimi hyjnor dhe as nuk e nxit zemërimin hyjnor kundër tij më lehtë sesa vetë mizoria e tij. Zoti e dëgjon zërin e të shtypërve dhe e ndëshkon shtypësin.

Njeri i zakonshëm

Bëhu i drejtë në udhëheqjen tënde dhe kërko pëlqimin e popullit, sepse pakënaqësia e popullit mund ta shkatërrojë kënaqësinë e disa të privilegjuarve, ndërsa pakënaqësia e disave gjithnjë humbet në kënaqësinë e shumicës. Mbaje në mend që disa të privilegjuar nuk do të jenë afër teje në momentet e tua të vështira: ata do të mundohen ta anashkalojnë drejtësinë, ata do të kërkojnë më shumë se çka meritojnë dhe nuk do të shfaqin mirënjohje për të mirat që u ke bërë. Ata nuk do t'i binden gjyqeve dhe nuk do të pendohen për gabimet e tyre. Është njeriu i zakonshëm ai që paraqet fuqinë e Shtetit dhe Fesë. Është ai që lufton kundër armikut. Prandaj, rri afër njerëzve dhe kujdesu për mirëqenien e tyre.

Qëndro larg nga personi që kqyr me i nxerr në pah dobësitë e tjerëve. Megjithatë, njerëzit nuk janë të lirë nga dobësitë. Është detyra e udhëheqësit që t'i mbrojë nga ato. Mos u mundo me i nxerr në pah ato që janë të fshehura, por mundohu t'i largosh ato dobësi që janë shfaqur. Zoti ka njohuri për gjithçka që është e fshehur prej teje dhe Ai do të merret me ato gjëra. Mundohu t'i mbulosh dobësitë e popullit dhe Zoti i mbulon dobësitë e tua. Zgjidhe nyjen e urrejtjes së ndërsjelltë ndërmjet popullit dhe administratës dhe eliminoji krejt ato shkaqe që mund t'i nxisin raportet e tensionuara ndërmjet tyre. Mbroje veten nga çdo veprim që mund të të duket i padrejtë. Mos u ngut me konfirmu çdo thashethem, sepse ai që bën thashetheme është mashtrues i veshur në petkun e mikut.

Këshilltarët

Kurrë mos prano këshillë nga personi koprrac, sepse ai e ka për qëllim ta dëmtojë zemërgjerësinë tënde dhe të të frikësojë se do të bëhesh i varfër. As mos prano këshillë nga personi frikacak, sepse ta dobëson vendosmërinë. Mos prano këshillë as nga personi lakmitar, sepse ta nxit lakminë dhe të shndërron në tiran. Koprracia, frikacakllëku dhe lakmia e privojnë njeriun nga besimi i tij në Zot.

Më i keqi nga këshilltarët është ai person që ka shërby si këshilltar për udhëheqësit e padrejtë dhe ka qenë bashkëpjesëmarrës në krimet e tyre. Kështu që kurrë mos lejo që të bëhen këshilltarët e tu ata persona që kanë qenë shokë të tiranëve dhe kanë marrë pjesë në krimet e tyre. Mund të gjesh njerëz më të mirë se këta, mund të gjesh njerëz inteligjent dhe mendjehapur dhe të panjollosur me mëkate, njerëz që asnjëherë nuk e kanë ndihmuar tiranin në ushtrimin e tiranisë apo kriminelin në kryerjen e krimeve. Njerëzit e tillë nuk do të jenë asnjëherë barrë për ty. Në anën tjetër, ata do të jenë burim i ndihmës dhe forcës për ty në çdo moment. Ata do të jenë shokët e tu dhe të huaj për armiqët e tu. Zgjedhi vetëm njerëzit e tillë që të jenë shokët e tu në jetën private dhe publike. Bile edhe në mesin e tyre, zgjedhi ata që më së shumti e çmojnë të vërtetën dhe që nuk të inkurajojnë në shfaqjen e tendencave të cilat Zoti nuk ka dëshirë që shokët e Tij t'i krijojnë. Mbaji afër vetës ata që janë të drejtë dhe që i frikësohen Zotit dhe bëju me dije që nuk ke dëshirë të të bëjnë lajka e as të të japin merita për ndonjë vepër që nuk e ke bërë, sepse tolerimi i lajkave dhe lavdërimit të pamerituar e stimulon mendjemadhësinë te njeriu dhe e bën arrogant.

Mos e trajto të mirin dhe të keqin njëjtë se ashtu i miri do të përmbahet nga të bërit mirë ndërsa i keqi do të inkurajohet të vazhdojë të bëjë keq. Shpërbleji njerëzit sipas meritave të tyre. Mbaje në mend që besimi dhe dashamirësia ndërmjet udhëheqësit dhe të udhëhequrve ushqehet vetëm përmes bujarisë, drejtësisë dhe përkushtimit. Prandaj, kultivoje dashamirësinë ndërmjet njerëzve; sepse dashamirësia e tyre të ndihmon me ju ik telasheve. Mirësia jote ndaj tyre do të shpërblehet me besimin e tyre, ndërsa keqtrajtimi me mllefin e tyre.

Mos i shpërfill traditat bujare që i kanë kriju paraardhësit tanë, të cilat e promovojnë harmoninë dhe përparimin në

mesin e njerëzve; dhe mos nis diçka që mund ta minimizojë dobinë e tyre. Njerëzit që i kanë kriju këto tradita e kanë marrë shpërblimin e tyre; por përgjegjësia do të jetë e jotja nëse prishen ato. Mundohu gjithmonë që të mësosh diçka nga përvoja e njerëzve të mençur dhe të urtë dhe konsultohu shpesh me ta për çështjet e shtetit në mënyrë që ta vazhdosh paqen dhe rendin, të cilët i kanë vendos pararendësit e tu.

Shtresat e ndryshme të njerëzve

Mbaje në mend që njerëzit përbëhen prej shtresave të ndryshme. Progresi i njërës varet nga progresi i tjetrës dhe asnjëra nuk mund të jetë e pavarur nga tjetra. Ne e kemi ushtrinë e formuar me ushtarët e Zotit. I kemi zyrtarët civilë dhe administratat e tyre, gjyqësorin tonë, inkasantët e tatimeve dhe zyrtarët e marrëdhënieve me publikun. Popullsia e përgjithshme përbëhet nga muslimanët dhe të tjerët dhe në mesin e tyre ka tregtarë dhe zanatlinjë, por dhe të papunësuar dhe të varfër. Zoti ka caktuar për ta të drejtat, përgjegjësitë dhe obligimet. Të gjitha janë të definuara në Kuranin e Shenjtë dhe në traditat e Profetit.

Ushtria, me madhështinë e Zotit, është si një kala për njerëzit dhe i jep dinjitet shtetit. E mban prestigjin e besimit dhe e siguron paqen ne vend. Pa të shteti nuk mund të qëndrojë. Por as ajo nuk mund të qëndrojë pa përkrahjen e shtetit. Ushtarët tanë janë dëshmuar të fortë para armikut tonë sepse Zoti u ka dhënë privilegj që të luftojnë për Atë; por ushtarët i kanë nevojat e tyre materiale që duhet t'i përmbushin dhe prandaj janë të varur nga të ardhurat që u jep shteti. Edhe ushtrisë edhe popullsisë civile, e cila paguan tatimet, i duhet bashkëpunimi me të tjerët – gjyqsorin, zyrtarët civilë dhe administratat e tyre. Gjykatësi zbaton ligjin civil dhe penal; zyrtarët civil mbledhin të hyrat dhe merren me administratën civile. Dhe pastaj vijnë tregtarët të cilët e shtojnë buxhetin e shtetit. Ata i menaxhojnë tregjet dhe janë në pozitë më të mirë se të tjerët për t'i kryer obligimet sociale. Pastaj vjen shtresa e njerëzve të varfër dhe në nevojë, të cilën shtresat tjera kanë obligim ta mbajnë. Zoti u ka dhënë të gjithëve mundësinë për të qenë të dobishëm; pastaj vijnë të drejtat e të gjitha këtyre shtresave ndaj administratës së shtetit, të cilat udhëheqësi duhet t'i plotësojë në të mirën e gjithë popullsisë – një detyrë që nuk mund ta kryejë si duhet pa e larguar interesin personal dhe pa kërkuar ndihmën e Zotit. Është e obligueshme për udhëheqësin që t'ia caktojë vetës këtë detyrë dhe të jetë i durueshëm me peripecitë dhe vështirësitë që mund t'i dalin gjatë kryerjes së detyrës së tij.

Pjesë nga Libri " Shtegu i Elokuencës "
Përgatiti : Redaksia VLERA

Formula e lumturisë

"Respektoni të mëdhenjtë dhe duani të vegjlit".

Këshilla na vije nga i Dërguari i Allahut profeti Muhamed – paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij.

Respekti dhe dashuria janë dy segmente kryesore me të cilat mund t'i përfitojmë zemrat e njerëzve.

Çdo njeri i mençur duhet t'i përshtatet vendit ku jeton dhe t'i respektojë doket dhe zakonet të arrijë vendi por duke pas parasysh që këtë doke e zakone të mos jenë në kundërshtim me principet e fesë islame.

Një popull pa vlera dinitoze, nuk do të vlerësohet nga të tjerë në botë, prandaj respekti dhe dashuria janë dy elemente kryesore që e bashkojnë.

Vartësia nga shpresat çorientuese

Në të njëjtën mënyrë si vetëbesimi dhe këmbëngulja janë faktorët më të mëdhenj pas suksesit, duke u varur nga shpresa të pabaza dhe duke u dashuruar pas aspiratave jorealiste, në zemrën e njeriut, në vend të përpjekjeve dhe veprimit, janë rezultatet e distancimit të njeriut nga realitetet e jetës.

Ndonjëherë, dëshira kënaqësish të veçanta dhe fantazime lënë një përshtypje kaq të thellë në mendjen e njeriut, saqë ai kapet rob i ëndrrave të parealizueshme, duke u bërë i paaftë të perceptojë faktet dhe të shohë realitetet. Persona të tillë kurrë nuk janë të suksesshëm në arritjen e perfeksionit dhe të lumturisë.

Imam Aliu, Udhëheqësi i Besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:

"I konsideroni shpresat si të gabuara dhe mos u mbështesni mbi to. Shpresa të tilla janë mashtruese e çorientuese dhe një njeri i cili i mirëpret ato, bie viktimë e mashtrimit të tyre."

Një nga rreziqet e mbështetjes mbi pritshmëritë iluzive dhe të papërshtatshme është se kur ato shkatërrohen si rezultat i pengesave, bëjnë që të lindin komplekse psikologjike te njerëzit. Në një nga thëniet e tij të çmuara, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) i konsideron pritshmëritë e dështuara si një ndër faktorët që të çojnë drejt kompleksve psikologjike.
Ai thotë:

"Ndjenja e poshtërimit dhe e inferioritetit te njerëzit lind si rezultat i shpresave dhe pritshmërive apo të besimeve të humbura."

Psikologët, gjithashtu e konsiderojnë dështimin dhe mossuksesin si një nga faktorët e rëndësishëm të një kompleksi inferioriteti dhe të një mungese besimi në vetvete.

"Ndoshta asnjë faktor nuk është më i dëmshëm në ndjenjën e respektit për veten sesa dështimi dhe ndëshkimi për këtë dështim. Dështimi bën që një njeri ta konsiderojë veten inferior ndaj të tjerëve dhe në përballje me disfatën, ai fillon të imagjinojë se është inferior ndaj njerëzve të tjerë. Dështimi shkatërron vetësigurinë dhe si rrjedhojë disfata zëvendëson vetëbesimin. Prandaj kur fëmijët dhe të rinjtë përballen me dështime të njëpasnjëshme, ata ndihen të poshtëruar dhe tek ata formohet një kompleks inferioriteti."

Një mësim nga i Dërguari Fisnik

Një nga metodat e Profetit të Islamit (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ishte të zhvillonte frymën e vetësigurisë dhe të mbështetjes në vetvete te ndjekësit e tij.

Nën hijen e drejtimit dhe të mësimeve të profetit, myslimanët fituan një ndjenjë të thellë vetëbesimi, një guxim madhështor, një vendosmëri të sigurt, ideale dhe superiore, në vend që të përfshihen nga shpresat e kota dhe të bien viktimë e dëshirave shkatërruese.

Ata vazhdimisht do të kërkonin mbështetjen e Zotit në të gjitha veprimet dhe aktivitetet e tyre, duke treguar vëmendje të vazhdueshme ndaj burimit - origjinës së virtytit.

Një nga bashkudhëtarët e profetit (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!) u përball me vështirësi të mëdha, si rezultat i varfërisë. Një ditë ai ndjeu se nuk mund të duronte dot më dhe kupa tashmë ishte mbushur dhe nuk mbante më. Pasi u konsultua me bashkëshorten, ai vendosi të takonte të dërguarin e Zotit dhe t'i tregonte atij rreth gjendjes së mjeruar dhe t'i kërkonte ndihmë.

Pasi e ndau mendjen, ai shkoi te profeti (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!) por, përpara se t'i shprehte atë çka mendonte, ai dëgjoi profetin (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!) t'i thoshte:

"Ne nuk do t'i japim ndihmesën tonë çdokush që e kërkon atë. Por nëse një individ pranon mbështetjen në vetvete dhe tërhiqet nga kërkesa për ndihmë nga të tjerët, Zoti do të përmbushë nevojat e tij."

Sapo dëgjoi këto fjalë, ai u tërhoq nga shprehja e qëllimit që kishte dhe u kthye në shtëpi.

Sidoqoftë, varfëria dhe mjerimi e bënë atë të mos duronte dot më dhe ditën tjetër ai u nis përsëri për ta takuar profetin (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!) dhe ta kryente atë që kishte vendosur.

Por përsëri, ai dëgjoi profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!) duke thënë të njëjtën gjë:

"Ne nuk do t'i japim me gjysmë zemre ndihmesën tonë atij që e kërkon atë. Por nëse një njeri do të pranonte mbështetjen në vetvete dhe tërhiqet nga kërkesa dhe nga lutjet për ndihmë nga të tjerët, Zoti do të përmbushë nevojat e tij."

Edhe këtë herë, ai vendosi përsëri të tërhiqej nga kërkesa dhe u kthye në shtëpi. Sidoqoftë, pasi nuk pa ndonjë shpresë për ndonjë lehtësim, për të tretën herë, ai shkoi te profeti (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!). Këtë radhë, Profeti, përsëriti të njëjtat fjalë.

Megjithatë, në këtë rast ai pati një ndjenjë force dhe besimi në vetvete kur dëgjoi fjalët e të Dërguarit Fisnik (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!). Atij iu duk sikur e gjeti çelësin për zgjidhjen e problemit.

Ndërsa po kthehej, ecte me hapa të qëndrueshëm dhe të vendosur. Ai hyri në mendime të thella, i tha vetes se nuk duhej t'i drejtohej njerëzve të Zotit për ndihmë. Prandaj vendosi që të mbështetej në fuqinë e jashtëzakonshme të Zotit dhe të bënte të pamundurën për të shfrytëzuar kapacitetet e tij të dhuruara nga ai.

Ai iu lut Zotit ta ndihmonte në punën që do të niste dhe ta bënte atë të sigurt në vetvete. Dhe pastaj filloi të mendonte se çfarë mund të bënte. Ai arriti në përfundim se duhej të nisej për në shkretëtirë, të mblidhte dru dhe t'i shiste. U nis për ta kryer atë që vendosi. Kërkoi një sëpatë dhe u drejtua për në shkretëtirë. Çdo ditë mblidhte dru, i transportonte në qytet dhe i shiste. Ai kishte një ndjenjë kënaqësie se po fitonte në saje të punës së tij.

Kaluan disa ditë dhe në këtë mënyrë ai vazhdoi derisa grumbulloi të ardhura për të blerë mjetet e veta dhe një kafshë për transportin e druve. Pasi vazhdoi të punonte për disa kohë, ai arriti të zotërojë pasuri të mjaftueshme dhe madje bleu edhe disa skllevër.

Një ditë i dërguari i Zotit (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!) e pa dhe i tha duke buzëqeshur:

"A nuk të thashë se nuk duhet t'i japim me gjysmë zemre ndihmesën atij që e kërkon atë. Por nëse njeriu përdor mbështetjen në forcat e veta dhe tërhiqet nga lutjet për ndihmë te të tjerët, Zoti do të përmbushë nevojat e tij?"

Samuel Smiles-i, një dijetar i njohur, shkruan:

"Mbështetja në vetvete është baza e çdo suksesi dhe progresi. Po ta zotëronte shumica e njerëzve këtë virtyt, ai do të bëheshin një komb i madh dhe i fuqishëm. Sekreti i rritjes dhe i fuqisë së tij qëndron në zotërimin e kësaj cilësie, sepse ajo forcon vendosmërinë e njeriut që është dobësuar nga vartësia te të tjerët.

Ndihmesa që dikush merr nga jashtë më së shumti dobëson forcën e tij të këmbënguljes dhe të përpjekjes; pasi në atë rast nuk ka arsye që të mundohet dhe të përpiqet.

Kjo është veçanërisht e vërtetë, sidomos në rastet kur ndihmesa e jashtme shkon përtej kufirit të nevojave. Në raste të tilla, mendja bëhet letargjike dhe shpirti i vendosmërisë dhe kapaciteti për përpjekje vdes te njeriu. Ligjet më të mira dhe rregullat i japin njeriut lirinë për t'u mbështetur në vetvete dhe për të menaxhuar jetën. Por njerëzit gjithmonë mendojnë se janë ligjet ato që sigurojnë lumturinë dhe rehatinë, jo sjelljet dhe përpjekjet e tyre.

Imam Aliu, udhëheqësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!),ka thënë: "Një njeri që nuk mund a ngrejë veten në lartësinë që ka mundësi të arrijë, nuk ka mundësi të ngrihet nga diçka tjetër." Dhe

"Njeriu që dështon në përpjekjet e tij, si rezultat i neglizhencës dhe i përtacisë do ta gjejë veten të shkatërruar dhe të dobësuar."

Gjeneza e planetit, ekuilibri i tij dhe orbita, pema e përkulur që e merr veten nga erërat e forta, burimet jetësore të çdo kafshe dhe perimeve, janë manifestime të shpirtit të pavarësisë dhe rrjedhimisht të mbështetjes në vetvete.

Marrë nga Libri Psikologjia Islame – Zhvillimi shpirtëror.

I NJEJTI KRUA FRYMËZIMI

Autor: Edlira Osmani

Ndër perlat më të bukura të letërsisë shqiptare janë vargjet e Naimit që gurgullojnë nga burimi i Sadiut, të ndjekura hap pas hapi nga fyelli melodioz i Rumiut. Tahajulat, ëndërrimet, të parat ëndërrime të bardha të poetit tonë të madh, të shkruara në gjuhen e embël perse. Naimi u ul në kopshtin e bukur të Sadiut dhe diti të mblidhte me shumë kujdes lulet më të bukura dhe aromën e tyre e hodhi në vargjet magjike që sot i lexojmë me endje...

O moj kohë e bukur, je lëndim
me dhëmbas e më sjell brengë
e hidhërim.
(N. Frasëri)

Tri ditë do të rroj i qetë prej shpatës,
kush gjeti gëzim në dhimbjen e botës.
(Sadiu)

I lexojmë këto vargje dhe na duket se janë pjesë e njëratjetrës dhe së bashku përbëjnë një poezi të tërë, një buqetë me lule të mbledhura nga një lulishte trëndafilash. Nuk mund të lemë pa përmendur se Naimi shkroi vargje prekëse për vdekjen e së bijës. Po ashtu edhe Sadiu shkroi vargje plot forcë elegjike për dhimbjen që i shkaktoi vdekja e të birit. Si besimtarë, të dy poetët i kushtuan Zotit një vend të rëndësishëm në poezitë e tyre.

Naimi e mendon Zotin kudo, duke patur parasysh idetë e tij panteiste. Edhe Sadiu si mistik që ishte e gjen veten në retë e parajsës, i dehur nga dashuria për Zotin.

"O Zot i qiellit pa anë e kufi
e luft e theve, me paqe e thirr!"
(Sadiu)

Në poezitë e Naimit hasim një tjetër mënyrë të të shprehurit të ndjenjës së tij drejt të Madhërishmit. Duke përdorur një simbol të poezisë, Naimi shpreh më shumë bukuri:

Zogu i mendjes po më sulet drejt
nga qielli
Në hapësirat plot me afsh e dritë dielli.

Këto vargje na kujtojnë udhëtimin mistik të zogjve drejt absolutes dhe ne i mendojmë ata të ulur në kopshtin e Sadiut duke ua shtuar bukurinë luleve erëmira.

Lulishtja ime, ah veshun ka humbë,
Zambaku i vyshkun nuk bëhet
më trembë.
(Sadiu)

Vargjet e këtyre poetëve të mëdhenj, të veshur plot bukuri, palcë gjuhësore dhe simbole të mrekullueshme, të ardhura dhe të lindura në parajsen e orientit, nuk ka inxhi që të krahasojë vlerën e bukurisë së tyre.
Vargjet e tyre duket se kanë rënë nga qielli pendëndritur dhe shpërndahen nga vajza nazemadhe, e veshur nga trendafilat dhe zymbylat që u sollën nga zogjtë njëshkëndonjës të pyjeve persiane.

Ti më shkon si Afërdita, nazemadhe
Posi zana ti më bredh, moj ndër livadhe.

Poezitë e Saadiut dhe të Naimit burojnë nga i njejti krua frymëzimi dhe ne i dëgjojmë më endje gurgullimën e tij melodioze.

Thënie të mençura

Në filozofi ju mësoni si të mendoni dhe jo çfarë të mëndoni".
"E dua filozofinë sepse ajo më jep shansin të diskutoj për gjëra të reja dhe të dëgjoj mendimet e të tjerve për to".
"Nëse planifikoni për një vit, mbillni oriz. Nëse planifikoni për një 10 vjet mbillni pemë e nëse planifikoni për 100 vjet, edukoni fëmijë".

VLERA INTERVISTOI PËR NJOHURITË RRETH QERBELASË

Në muajin e Muharremit të vitit 61 Hixhër (përafërsisht 20 tetor 680), është shfaqur një ngjarje në një vend të Irakut, të quajtur Kerbela, afër bregut të lumit Eufrat. Për historinë e asaj kohe, kjo ishte një ngjarje e parëndësishme. Një ushtri e madhe, e cila ishte mobilizuar nga regjimi i Emevitëve, rrethoi një grup të vogël që numëronin më pak se njëqind persona dhe i bënin presion ndaj tyre për të shprehur besnikërinë ndaj Halifit të kohës dhe t'i nënshtrohen autoritetit të tij. Grupi i vogël rezistoi dhe pasoi një betejë e ashpër, në të cilën u vranë të gjithë.
Në atë kohë është menduar se kjo betejë do të harrohet me kalimin e kohës dhe se do të zbehet kujtimi për të, sikur që janë harruar betejat e vogla të ngjaashme që kanë ndodhur në ato kohëra. Por, beteja që kishte ndodhur më 10 Muharrem, ishte shndërruar në një zjarr sinjalizues dhe një inspirim për gjeneratat e ardhshme.

Ndjenjat e të intervistuarve pas njoftimit me ngjarjen e Qerbelasë.

Ardita: Është një histori shumë e dhimbshme. Edhe herën e parë dhe tani që e dëgjova, më duket sikur po e përjetoj të gjithë historinë. Herë ndjej mëshirë dhe herë inat e zemërim. Të vrasësh pa mëshirë një bebe gjashtë muajshe, vetëm që të mbrosh gënjeshtrat, është mizori.

Irisi: Unë ndjej shumë mëri dhe urrejtje për Jezidin dhe shumë respekt për Imam Huseinin. Gjithashtu, për Imam Husenin, ndjehem krenare, sepse ai e përfaqësoi denjësisht fenë islame dhe e paraqiti atë siç ishte në të vërtetë. Mbrojti të drejtën dhe të mirën. Ndërsa Jezidi ishte një mëkatar që bëri shumë padrejtësi mbi njerëzinë dhe fenë islame. Unë mendoj se Jezidi ishte i dënuari, për rrugën e keqe që zgjodhi. Që në atë moment, ka filluar dënimi i tij.

Erinda: Të mësosh një histori shumë prekëse ku njerëz të pafajshëm vdesin nga padrejtësia është shumë inte-

resante dhe emocionuese gjithashtu. "Fëmija" është një simbol i mirësisë dhe fati i tij tragjik të mallëngjen. Ç'faj ka një foshnje vetëm gjashë muajshe. Pse vallë kjo, apo ndoshta... Mesazhi që do të përcillja është: ndiqe traditën e Imam Huseinit (as) dhe largohu nga e keqja.
Hatixhe: Unë kur kam lexuar për Qerbelanë unë jam ndier shumë keq, sidomos për fëmijën e vogël gjashtë muajsh, për atë që i bënë dhe sigurisht, për të gjithë ato që përfunduan të vdekura. E vetmja gjë që do të doja është që në këtë botë të mos ekzistonin njerëz si Jezidi. Të ekzistonin vetëm njerëz si Imam Huseini, të sinqertë dhe të mirë.

Erion: Është padrejtësia më e madhe të vrasësh një fëmijë të pafajshëm dhe një njeri që kërkon ujë. Ndjej një adhurim të madh për sakrificen që bëri Imam Huseini(as), për të mbrojtur të drejtën dhe fenë islame. Ndej njëkohësisht edhe një dhimbje të madhe për atë që njerëzit e padrejtë i bënë Imamit.

Esra: Në këtë momente ndihem shumë keq për fatin e familjes së Imam Huseinit. Por ndihem dhe e gëzuar pasi mësova një të vërtetë. Edhe pse e hidhur, është e vërtetë.

Halimja: Ndjej një dhimbje shumë të madhe. Kur e dëgjoj këtë histori, ndihem shumë keq. Eshtë vërtetë një histori që të prek në shpirt. Shpresoj që ngjarje të tilla, të mos përsëriten kurrë. Kështu e gjithë bota do të shkatërrohej. Unë në këtë moment, ndjej shumë hidhërism për atë çka i i ndodhi familjes së Imam Huseinit(as).

Hasani: Ndjej rrëqethje, mërzi të thellë në shpirt dhe keqardhje për atë çka i ndodhi Imam Huseinit dhe familjes së tij. Kjo do të ngulitet thellë në memoren time. Do ta kujtoj çdo çast, duke vënë veten time në poziten e asaj familje që kërkonte e luftonte për të drejtën dhe për paqen.

Përgatiti redaksia e Revistës VLERA.

FLETË MUSINJA PËR NAIM FRASHËRIN

e pa dëgjuar më parë.

Bota fetare filozofike pasqyrohet kudo edhe bëhet një doktrinë. Kjo lë gjurmë të forta në të gjitha shkrimet e Naimit, më tepër se çdo shkrimtar tjetër shqiptar i kohës së shkuar dhe i kohës së sotme.

Bota fetare filozofike pasqyrohet kudo edhe bëhet një doktrinë. Kjo lë gjurmë të forta në të gjitha shkrimet e Naimit, më tepër se çdo shkrimtar tjetër shqiptar i kohës së shkuar dhe i kohës së sotme.

Shqipëria, një nga shtetet më të vegjël të kontinentit të Evropës, gjithmonë e shtypur dhe e skllavëruar prej popujve të ndryshëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ishte ngritur me armë në dorë, nga të gjitha anët e vendit. Ky shekull ka rëndësi të madhe për tokën shqiptare. Gjatë këtyre përpjekjeve ajo kreu nga gjiri i saj shumë njerëz të dyfekut, por edhe shumë pendëtarë. Ata me anën e shkrimeve, lartësuan ndjenjën e atdhedashurisë. Këto vepra, që kanë secila rëndësinë e vet, të gjitha janë me vlerë kombëtare dhe letrare.
Çështja shqiptare pati fatbardhësinë të shkruhej në mënyrë të bukur dhe të kulluar në veprat e poetit më tipik të kohës. Ajo gjeti burimin më të ndritur në gjeninë e poetit më të madh të kohës së tij Naim Frashëri.
Më parë se të bëj kritikën e çdo vepre të poetit, dua t'i paraqes lexuesit botën mendore të Naimit, ku pasqyrohen në të gjitha ndjenjat shpirtërore. Më parë se çdo gjë, duhet së pari të ndajmë dhe të analizojmë format e ndryshme, të cilat na paraqiten me të shtatëmbëdhjetë veprat që na ka lënë shkruar. Pika më karakteristike, që zë vendin e parë në studimin tim, boshti kryesor rreth të cilit Naimi vërvitet shumë herë, është bota fetare - filozofike. Më vonë, prej saj rrjedhin dhe karakteristikat e tjera ideologjike : politike, sentimentale, shkollore etj.
Bota fetare filozofike pasqyrohet kudo edhe bëhet një doktrinë. Kjo lë gjurmë të forta në të gjitha shkrimet e Naimit, më tepër se çdo shkrimtar tjetër shqiptar i kohës së shkuar dhe i kohës së sotme.

Në mes të botës fetare - filozofike të Naimit, më parë se çdo gjë tjetër është Zoti, fuqi e mbinatyrshme, fuqi prodhuese edhe udhëheqëse të çdo lëvizjeje tokësore dhe qiellore. Naimi e kupton këtë fuqi hyjnore në formë panteiste. Nga ky sistem dhe me këtë mënyrë forcon edhe më shumë parimin e pavdekshmërisë së lëndës. Ajo nuk shkatërrohet, nuk humbet, po ndryshohet gjithmonë. Si të gjithë poetët mistikë, që Naimi është përpjekur gjithmonë të largohet, por nuk ka mundur të shkëputet krejt; bazën konceptive të tij te një Zot i vërtetë, që është një prej fillimit dhe një do të jetë: i përjetshëm. Ai beson te një Zot, i cili për madhërinë e Tij, tregoi veten në çdo gjë. Njëkohësisht çdo gjë është tek ai. Në këtë mënyrë ai krijoi botën. Bëri gjithësinë ku ndodhet fryma hyjnore e tij (anima universale). Ky shpirt, që ndodhet kudo, që fshihet në çdo gjë, ka forcë prodhuese. Ajo, me dashurinë e saj hyn kudo dhe kërkon të udhëheqë çdo veprim. Prej këtij koncepti themeltar, të tjerë rrjedhin si p.sh. ajo: natyra nuk ka në vetvete një fuqi të vërtetë dhe nuk mund të krijojë. Çdo gjë që shikojmë, çdo gjë që lulëzon, qoftë dhe lulja më e vogël, nuk bën gjë tjetër, veçse të na dëftojë bukurinë dhe madhështinë e Zotit, sepse vetëm ky ka fuqi të krijojë. Duke gjykuar në këtë mënyrë, pa dashur, Naimi bie ballë për ballë me njeriun, me natyrën më të përsosur në këtë botë. Ai është fytyra e Zotit, sepse kur deshi Zoti i madh dhe i vërtetë të dilte në shesh, atëherë krijoi njeriun. E bëri mbret të natyrës, i dha mendje të gjykojë me shpirt që të mëshirojë. Përveç kësaj i dha mundësinë të njohë veten e tij, po kështu di se ç'është Perëndia. Por vetëm Zoti, si fuqi më e lartë e gjithësisë ka zotësi të krijojë, kurse njeriu jo : ai nuk mundet se është fytyra e Zotit, sepse tek i biri fshihet i ati. Njeriu është krijuar në këtë botë për të punuar.

Kërkon të ngrihet lart, të largohet nga mëkatet, porse prapë gabon. Me një fjalë, nuk është gjë tjetër, veçse një fenomen i natyrës, që ka qenie të ndryshuar. Nuk është sot, siç ka qenë dje dhe nesër nuk do të jetë siç ka qenë sot. Dita - ditës ndryshohet, përtërihet, merr pjesë në natyrë, e cila sundohet dhe udhëhiqet prej Zotit. Ideja e Zotit, fuqia e cila i jep jetë çdo gjëje e shton më shumë parimin e " Divina Provvidenza ". Kjo forcë kaq e madhe është e fshehur dhe rregullon të gjithë ngjarjet njerëzore. Çdo gjë që ngjet, gazet, hidhërimet, fatkeqësitë në vatrat familjare, të gjitha këto kanë një qëllim. Ne nuk e kuptojmë, por është e nevojshme, që në të tilla raste të kemi besim tek i madhi Zot. E keqja e sotme, nesër shpërblehet prej Tij. Ai është i madh dhe i përsosur, prandaj fatkeqësia që ndodh, bie nga prapa të mirën. Kjo është pika më kryesore në botën mendore të Naimit, ku na pasqyrohet shpirti i tij. Bota mendore e tij, me gjithë parimet e sipër treguara nuk është e bazuar në idera fataliste ose krejt dogmatike, porse janë mendime kritike, ku merr pjesë botëkuptimi ynë dhe për këtë shkak bëhen filozofike. Siç thashë dhe më parë, prej konceptit fetar filozofik – rrjedhin edhe format e ndryshme të botës mendore. Më para nga të gjitha është ajo etike dhe shoqërore. Naimi është reformator i një shoqërie të re, të bazuar mbi mirësinë, mbi urtësinë dhe vëllazërinë e gjithë njerëzve. Ai dëshiron me mish e me shpirt që njerëzimi të kthehet dhe të rrojë si më parë, në mënyrë shumë të thjeshtë dhe primitive, të frymëzuar prej dashurisë së Zotit. Prej këtij idealizmi fetar - moral dhe shoqëror, poeti futet në botën ideale - politike dhe sentimentale. E vërteta është që Naimi dëshiron si e si të ndreqë shoqërinë, porse kështu duke dashur arrin në idealin e tij më të lartë: të zgjojë nga gjumi i rëndë dhe nga skllavëria popullin shqiptar. Nuk do që ky popull i vjetër, me një të shkuar të shkëlqyer të rrojë në robëri. Mjaft në harresë, kundrejt detyrave të tokës shqiptare.

Kjo gjë e shpuri në greminë dhe të pushtohet lehtësisht nga shtetet fqinjë. Ideali politik është pjesa më e bukur e veprave të poetit. Naimi në këto vargje shkriu veten e tij, sepse kjo ka rëndësi të madhe për të dhe për popullin shqiptar dhe me këtë ideal ai e ushqeu fantazinë në kohën e rinisë. Këtë ëndërr ushqeu sa herë shkruante dhe kjo ëndërr u lëkund në kohën e pleqërisë. Këtë ideal u këshillonte bashkëatdhetarëve të tij. Ishte idea e një Shqipërie të lirë, që ushqeu gjer në minutat e fundit. Me këtë shpresë Naimi mbylli sytë përgjithmonë. Duke i dhënë rëndësi të madhe idealit politik, Naimi iu shtrua punës. Ai donte të edukonte rininë, sepse atje shpresonte. Për të shkruante nat ' e ditë, sepse donte të mbillte me duart e tij zellin e mësimit ; sepse vetëm në këtë mënyrë kish të drejtë të kërkonte punë dhe sakrificë prej tyre. Filizat e reja duheshin ushqyer mirë që të kuptonin idenë e dashurisë për atdhe, vëllazërinë, edhe më në fund lirinë. Mblidhte që të korrte, se ashtu mendonte. Po, për të kuptuar poezinë ose më mirë temperamentin poetik të Naim Frashërit, duhet të marrim parasysh edhe pamjet e tjera të botës së tij mendore, e sidomos në pjesën ku pasqyrohen të fshehtat e shpirtit të tij, atë anë të cilën mund ta quajmë idealizmë sentimentale. Kjo ka rëndësi të madhe në krahasim me ato që thamë më sipër. Naimi, në poezitë me këtë karakter, na paraqitet si kreatura më e njerëzishme. Shpirti i tij është shumë delikat dhe tronditet përpara hidhërimeve të të tjerëve e të tijat, që janë aq të ndjeshme, dëftojnë një butësi të madhe shpirtërore dhe ka zemërbardhësinë edhe sinqeritetin e një foshnje. Atij i dhimbet për çdo gjë në gëzimet dhe në fatkeqësitë e kreaturave më të vogla. Ai qan e qesh me ta. Poeti frymëzohet dhe mbetet me gojë hapur përpara bukurisë së natyrës.

Ai mahnitet për madhështinë e saj me të gjitha format zemra e një hiri, e rreh me të fortë përpara syve magjepsës të një gruaje të bukur. Për Naimin, e cila është përpara syve të tij dhe pasqyrohet edhe në idealin fetar, nuk është gjë tjetër, veçse Perëndia. Për atë digjet e përvëlohet, për atë shkrihet dhe do të bëhet baltë e pluhur, sepse është kreatura më e përsosur, ajo që i jep jetë çdo gjëje, është burimi i çdo bukurie. Naimi pra, është poeti mistik. Është një mendonjës i thellë. Ai dëshiron, si dhe të tjerët, të ngrihet lart shpirtërisht dhe të arrijë në sferat më ideale të kohës mendore. Ai frymëzohet vetëm prej së mirës dhe prej dashurisë së Zotit. Kjo ka vlerë të madhe për ne, sepse kemi përpara syve vargje, vjersha të cilat të bëjnë të ëndërrosh me sy hapur. Kjo meritë është e përshtatshme vetëm për ata njerëz të lartë, ashtu siç qe me të vërtetë Naim Frashëri.

Nuk dua të them fjalë të shumta dhe të shtoj tjetër, më tepër sec thashë më parë. Megjithatë e gjej të arsyeshme, që lexuesit të paraqesin disa njoftime të tjera, të cilat lidhen ngushtë me botën e tij mendore. Janë shumë të pakta ato vargje ku njeriu mund t'u jap një vlerë me të vërtetë artistike. Po megjithatë, nëpërmes poezive të shumta mund të gjejmë disa vargje, të cilat kënaqin shpirtin tonë nga bukuria e madhe, jo vetëm si ide, porse dhe si penë.

Ai që di të shijojë poezinë, po të kërkojë, do të gjejë me të vërtetë pjesë të zgjedhura, të cilat edhe përpara çdo kritike të rreptë, ato mbajnë një vend me të vërtetë me rëndësi letrare. Naimi është idealist, i lidhur shumë ngushtë me idetë e tij shpirtërore. Ai kërkon që këto mendime t'i shkruajë në mënyrë të thjeshtë e sidomos të frymëzuar prej një forme ardoria. Ky është një nga shkaqet që e shtyjnë Naimin të përsërisë me mijëra herë atë që ka në mend dhe atë që ia do shpirti. Ai nuk ka frikë se përsëritë, zepse për atë kanë vlera mendimet, ose më mirë se mendimet qëllimi i tij që parashikon t'ia arrijë, në mos shpejt, por edhe vonë.

Për këtë shkak, ne gjejmë te Naimi qelizën e parë, e cila prodhon dhe i jep zemër poetit të shkruajë natë e ditë, pa u kodhur aspak. Mund të themi, pa u menduar, se e gjithë puna e tij, ajo që përfshin botën poetike dhe atë individuale qëndron vetëm në një gjë : Atdheu. Për të mirën e atdheut derdh të gjitha energjitë e tij për natë, ku dëfton të gjitha idetë fetare - filozofike, edukuese dhe sentimentale. Atdheu - qëndron më lart se çdo gjë tjetër dhe si Apostoll i tij. Prandaj çdo shqiptar, i cili nesër do të ketë mundësinë të punojë mbi veprat e Naimit dhe të bëjë një kritikë më të gjerë, ka të drejtë të marrë parasyh të gjitha rrethanat në të cilat ka shkruar Naimi. Nuk duhet harruar dhe gjendja e kohës dhe shkalla në të cilën gjendej letërsia jonë kombëtare. Naimit i falen gabimet, përpara qëllimit, që ka dashur t'ia arrijë dhe shpresës, që ka ushqyer gjer në minutat e fundit. Qëllimi im ka qenë si, që të japë kritikat e veprave të Naimit, duke i ndarë ato sipas kohës që janë shkruar. Po, me gjithë përpjekjet e mia, nuk qe e mundur të gjeja kohën e përpiktë, si dhe datat ku i ka shkruar veprat. Unë, nga ky shkak u shtrëngova t'i ndaj, duke marrë parasyh karakteret, ose më mirë lëndën që përmbajnë. Duke ndjekur këtë udhë, ka mundësi të madhe të shfaqet më mirë shpirti i Naimit dhe të na dëftohet sahtu siç është në të vërtetë, duke i dhënë vlerë dhe botës së mendore.

Ndarja që do të jap më poshtë është një lloj pasqyre, ku na paraqiten të gjitha veprat të vëna në kategoritë përkatëse:

Veprat me karakter fetar :
1) Fletore e bektashinjve, 2) Qerbelaja dhe 3) Mësime.
II. Vepra me argument shkollor : 1) E këndimit të çunave, 2) Istori e përgjithshme ; 3) Istori e Shqipërisë, 4) Dituritë, 5) Gjuhësija, 6) Iliadha e Omerit – Mërija e Aqileut
III. Vepra me argument politik : 1) Dëshira e vërtetë e shqiptarëve dhe 2) Istori e Skënderbeut.
IV. Vepra me argument sentimental : 1) Tehajlat (persisht), 2) Eros (greqisht) dhe 3) Bagëti e Bujqësia.
V. Vepra me argumente të ndryshme : 1) Parajsa dhe fjala fluturake, 2) Vjersha dhe 3) Lulet e verës !.
Ky studim është përmbledhje e tezës së Musine Kokalarit, për Naim Frashërin.

U mbajt në Romë, 1941, M.K 22/1/1942

Prijësi i Besimtarëve

Imam Aliu

Pas Haxhit të fundit të njohur si Haxhi Lamtumirës, Profeti në zbatim të ajetit **"O i Dërguar, shpalle atë që je i urdhërnar sepse nëse nuk e bën, nuk e ke plotësuar misionin tënd"**, Profeti Muhamed s.a.a. urdhëroi që në një vend të quajtur Ghadir-Khum të ndaleshin gjithë haxhinjtë dhe të ngritej një mimber nga shalat e deveve.

Pasi i Dërguari u ngjit lart, mbajti një hutbe (fjalim) të gjatë në të cilën lavdëroi Allahun dhe sqaroi çështje të ndryshme të besimit dhe pastaj pyeti të pranishmit:

"O njerëz, a dëshmoni se unë e kam kryer misionin tim ashtu siç duhet?"

Ata të gjithë njëzëri ju përgjigjën me:

-"Po, dëshmojmë o i Dërguari i Zotit."

Pastaj Ai i pyeti përsëri:

"A dëshmoni se unë jam Mevla(udhëheqës, prijës) i çdo besimtari dhe besimtareje dhe se kam të drejta mbi ju më tepër seç keni ju mbi vetat tuaja?"

Ata ju përgjigjen përsëri me

"Po, dëshmojmë o i Dërguari i Allahut"

Atëherë Profeti mori dorën e Aliut dhe e ngrit lart duke thënë:

"Për cilindo që unë kam qenë Mevla (Udhëheqës, Kujdestar, Prijës), pas meje Aliu do të jetë Mevla i tij".

Pastaj ngriti duart dhe bëri këtë lutje:

"O Zoti im, bëhu mik me cilindo që do miqësojë Aliun dhe armik me cilindo që do armiqësohet me atë".

Pas kësaj profeti Muhamed s.a.a. urdhëroi që të gjithë të ja uronin Aliut këtë Mision Hyjnor, dhe të parët që ja urusan pas Profetit ishin Ebu Bekri dhe Omeri duke i thënë:

"Urime o Ali i Ti sot u bëre Mevlaja ynë dhe i çdo besimtari dhe besimtareje".

Kjo ceremoni zgjati 3 ditë.
Pas caktimit të Aliut "Mevla" si prijës të besimtarëve nga ana e Profetit me urdhër Hyjnor, zbriti ajeti i fundit i Kur'anit:

"Sot plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha për ju Islamin si fe".

Allahu na mundësoftë që të bëhemi nga pasuesit e vërtetë të Aliut dhe Imamëve të Pastër nga dera e Tij!

Arben A. Alljaj,
Kom-Iran, 8 Gusht 2020

DOBITË NGA EMRAVE E BUKU

Përmes ajeteve kur'anore, Allahu i Lartësuar i mëson robërit e Tij besimtarë se me çfarë fjalësh t'i drejtohen Atij. Ja si thuhet në Kur'anin Fisnik, në suren A'raf, ajeti 180:

وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا وَذَرُوا الَّذِينَ يُلْحِدُونَ فِي أَسْمَائِهِ سَيُجْزَوْنَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

ٱلْبَاسِطُ

21. El-Basit (Dhënësi)

Ai që reciton këtë emër 10 herë në namaz të mëngjesit me duart e hapura (kijam, rekati i dytë) do të përfitojë pasuri.

ٱلْخَافِضُ

22. El-Hafid (Përulësi)

Ai që e reciton këtë emër 16 herë çdo ditë, do të jetë i mbrojtur nga fatkeqësitë, shqetësimet dhe rreziqet.

ٱلْمُذِلُّ

25. El-Mudhil (Nënshtruesi)

Ai që reciton këtë emër 75 herë, do të parandalohet nga fitimi i xhelozisë.

ٱلسَّمِيعُ

26. Es-Semi'u (Dëgjuesi)

Ai që reciton këtë emër 100 herë pa folur me askënd të enjten pas namazit të drekës, Allahu do t'ia plotësojë atij/asaj çdo dëshirë.

ٱلْعَدْلُ

29. El-'Adl (i Drejti)

Ai që ha nga kjo botë pasi ta ketë shkruar këtë emër natën e premte, do të respektojë rendin e Tij.

ٱلَّطِيفُ

30. El-Latif (i Buti)

Ai që reciton këtë emër 100 herë pas kryerjes së dy rekateve namaz, të gjitha dëshirat e tij do të plotësohen.

ٱلْكَبِيرُ

37. El-Kebir (i Madhi)

Ai që reciton këtë emër 100 herë, do të ketë konsideratë.

ٱلْحَفِيظُ

38. El-Hafidh (Ruajtësi)

Ai që e reciton këtë emër 16 herë çdo ditë, do të jetë i mbrojtur nga fatkeqësitë, shqetësimet dhe rreziqet.

ٱلْمُقِيتُ

39. El-Mukit (Ushqyesi)

Ai që reciton këtë emër në një gotë me ujë dhe ia jep këtë ujë fëmijës që ka sjellje të keqe, ajo do të ndihmojë fëmijën në arritjen e një sjelljeje më të mirë.

ٱلْحَسِيبُ

40. El-Hasib (Llogarimarrësi)

Ai që e reciton këtë emër për shtatë ditë e net 70 herë duke filluar të enjten dhe në herën e 71 e reciton "HasbiAll-llahul-Hasib" do të jetë i lirë nga frika në grabitje dhe xhelozi.

R TË ZOTIT - ESMAUL HUSNA

ٱلْرَّافِعُ

23. Er-Rafi' (Lartësuesi)

Recitimi i këtij emri 100 herë gjatë ditës dhe natës, do të bëjë personin më të lartë dhe të pasur.

ٱلْمُعِزُّ

24. El-Mu'izz (Ngritësi)

Recitimi 140 herë i këtij emri pas lutjes së namazit të jacisë, do të ndihmojë në arritjen e dinjitetit në sytë e të tjerëve.

ٱلْبَصِيرُ

27. El-Basir (Vështruesi)

Ai që reciton këtë emër 100 herë, pas lutjeve të së premtes, do të marrë nderim, vlerësim dhe respekt në sytë e të tjerëve.

ٱلْحَكَمُ

28. El-Hakem (Gjykuesi)

Ai që reciton këtë emër shpesh gjatë natës, shumë sekrete do t'i zbulohen atij/asaj.

ٱلْخَبِيرُ

31.El-Habir (i Gjithëinformuari)

Ai që reciton këtë emër, do të lirohet shpejt nga ndonjë zakon i keq.

ٱلْحَلِيمُ

32. El-Halim (Përdëllimtari)

Shkruani këtë emër në një copë letre dhe vendosni aty ku farat mbillen, kjo do të parandalojë nga çdo fatkeqësi dhe shkatërrim.

ٱلْعَظِيمُ

33. El-Adhim (Madhështori)

Ai që reciton këtë emër shpesh do të marrë respekt nga të tjerët (do të jetë i respektuar).

ٱلْعَلِيُّ

36. El-'Alijj (i Larti)

Recitimi i shpeshtë i këtij emri ndihmon në fat dhe në udhëtim.

ٱلْشَّكُورُ

35. Esh-Shekur (Mirënjohësi)

Recitimi i këtij emri 41 herë, do të ndihmojë në shërimin nga depresioni.

ٱلْغَفُورُ

34. El-Gafur (Falësi)

Recitimi i këtij emri ndihmon në shërimin nga dhimbjet e kokës, etheve dhe depresionit.

ٱلْجَلِيلُ

34. El-Gafur (Falësi)

Recitimi i këtij emri ndihmon në shërimin nga dhimbjet e kokës, etheve dhe depresionit.



Vexhi Buharaja

DHE FIGURA E SHUMANSHME E NJË DIJETARI ORIENTALIST SHQIPTAR I CILI U LA NË HIJE PËR SHUMË KOHË

Msc.Ermal BEGA

Fatkeqësisht, ashtu siç ndodh në shumicën e rasteve, dhe kjo duket si një virus tek shqiptarët, nuk i njohim mirë, për të mos thënë fare, figurat dhe personalitet tona historike dhe të sotme. Nuk dimë të vlerësojmë ata intelektualë të cilët nuk kërkojnë asgjë nga familjarët dhe populli i tyre, por vetëm kontribuojnë për qëllime shumë të larta, për të thënë dhe hyjnore, dhe vetëm e vetëm për t'i shërbyer popullit të tyre pa asnjë interes, pa dyfytyrësi, pa qëllime të errëta etj.

Për mua, e tillë ka qenë dhe figura e të ndjerit, studiuesit dhe orientalistit të famshëm shqiptar Vexhi Buharaja. Ai lindi në lagjen e vjetër dhe të bukur orientale **"Murat Çelepi"** të qytetit të bukur dhe historik të Beratit, **më 12 Maj 1920 dhe ndërroi jetë po atje më 5 Korrik 1987,** në moshën **67 vjeçare,** dy vjet pas ndërrimit jetë të diktatorit Enver Hoxha, i cili ia shkatërroi jetën dhe personalitetin Vexhi Buharasë sa ishte gjallë.

Ai ka qenë letrar, poet, shkrimtar, orientalist, mësues, epigrafist dhe përkthyes shqiptar, i cili ka përkthyer shumë vepra nga osmanishtja e persishtja, edhe pse ishte njohës i nëntë gjuhëve të huaja, të lindjes e perëndimit. Babai i tij, Ibrahimi dhe gjyshi i tij, Ismaili, ishin të njohur në Berat si njerëz me kulturë të lartë fetare dhe atdhetare, dhe që njihnin shumë gjuhë të huaja gjithashtu, nga të cilët dhe Vexhiu mori themelet e kulturës botërore dhe gjuhëve të huaja.

Mësimet fillore i kreu në vendlindje. Pastaj shkoi në Tiranë ku vazhdoi shkollën në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë, dhe u diplomua në vitin 1940. Nga ky vit e deri më 1944 ai qëndroi në Tiranë ku nisi të punonte në revistën **"Kultura Islame",** organ i Komunitetit Musliman në atë kohë. **Vitet 1940-1944** njihen si vitet ku ai ishte më i angazhuar me punë krijuese. Gjithashtu, ai shkruante poezi dhe shkrime të tjera në gazetat dhe revistat e kohës, si në gazetën "Tomorri", në revistën "Kultura Islame", **"Zani i Naltë"** dhe **"Njeriu",** ku disa herë shkruante me pseudonime për shkak të gjendjes së pasigurtë komuniste që gjendej në atë kohë. Disa nga pseudonimet e tij ishin **"Valater Çokdari"** dhe **"Lulëzira".**

Pas 1944, meqenëse ishte gjendje lufte, ai u kthyer në Berat për t'u kujdesur për familjen e tij. Atje, ai nisi fillimisht të punonte për pak kohë si referent në shtëpinë e kulturës, por më vonë dashakeqësit komunistë e burgosën duke e akuzuar për propagandë kundër qeverisë së sapo dalë komuniste. Aty në burg mësoi dhe gjuhën ruse, të cilën pasi doli nga burgu e dha si lëndë mësimore në shkollë. Më pas, u kthye në Tiranë ku vazhdoi studimet në degën e gjuhës dhe letërsisë, ndërsa në vitin 1965 u pranua në Sektorin e Historisë së Mesjetës, pranë Institutit të Historisë në Tiranë. Aty mblodhi, përktheu në shqip dhe transkriptoi rreth 250 mbishkrime osmane, ndërsa pas tre vitesh e përzunë nga aty. Sipas historianit Ahmet Kondo, i cili në vitin 1995 ka botuar librin "Vexhi Buharaja - njeriu, poeti, dijetari", puna e Buharasë në Institutin e Historisë si përkthyes nga gjuha osmane u vu në shërbim të disave që bënë emër si punonjës shkencorë në mënyrë të padrejtë në kurriz të tij. Kjo do të thotë se gjatë

punës në Institutin e Historisë, atë e kanë shfrytëzuar shumë të tjerë të cilët më vonë u njohën si "specialistë" të osmanishtes. Me të drejtë, në atë kohë ka pasur shumë studiues të rinj, të cilët e mësuan osmanishten nga Vexhi Buharaja për qëllime studimore. Njëri prej tyre ishte dhe **Dhimitër Antoni,** një arumun (vlleh) ortodoks nga Tirana i cili sipas wikipedia-s thuhet se prej kujt e ka mësuar gjuhën osmane, ku përveç **Haki Sharofit e Jonuz Tafilaj,** përmendet dhe emri i **Vexhi Buharasë.**

Edhe pse mbiemri i tij i vërtetë ka qenë Vexhiu ka qenë nga përkthyesit e parë dhe të vetëm shqiptarë nga puna e palodhur e të cilit sot mund të lexojmë në shqipen tonë dokumente të Rilindjes Kombëtare dhe ato të Lidhjes së Prizrenit. Po ashtu, bota akademike shqiptare, përveç kontributeve të tjera, i detyrohet atij për përkthimin e veprave të mëdha klasike të letërsisë perse, si **"Shah name-ja" (ose "Libri i mbretërve")** e Firdeusit (e cila fatkeqësisht nuk u botua sa ishte gjallë ai) si dhe **"Gjylistani dhe Bostani"** nga Saadiu, të dy nga letrarët më të mëdhenj të letërsisë klasike perse dhe trashëgimisë së letërsisë botërore. Vexhiu ka përkthyer gjithashtu nga persishtja dhe veprën **"Ëndërrime" të Naim Frashërit,** emrin e të cilit e mban dhe instituti ndërkombëtar **"Naim Frashëri"** në Prishtinë, ku ne jemi mbledhur sot. Po ashtu, ai përktheu nga osmanishtja dhe dramën **"Besa"** të Sami Frashërit.

Pas vetes, Vexhi Buharaja la shumë historianë dhe studiues beratas të cilët shkruajtën për jetën dhe kontributet e tij. Për veprat dhe kontributet e tij janë shkruar dhe disa libra, ku ndër më të spikaturit mund të përmendim veprën **"Vexhi Buharaja - njeriu, poeti, dijetari",** përgatitur dhe pajisur me shënime **nga Ahmet Kondo,** dhe botuar në vitin 1995 nga shtëpia botuese **"Uegen" në Berat.** Të tjerë që kanë shkruar për të kanë qenë Yzedin Hima që ka shkruar librin "Vexhi Buharaja pa mite e mjegull" (i cili ka mbrojtur me të temën e masterit). Për të kanë shkruar shumë personalitete të ndryshëm shqiptarë si dhe janë bërë seminare për kontributin e tij në fushën e përkthimeve dhe dorëshkrimeve orientale. Prej vitesh, është për t'u vlerësuar dhe kontributi i pamasë i fondacionit kulturor-iranian "Saadi Shirazi" në Tiranë, të cilët kanë botuar dhe shumë shkrime në revistën "Perla", si dhe janë botuesit e librave **"Shahname" dhe "Gjylistani e Bostani".**

Libroteka publike e qytetit të Beratit si dhe medreseja e qytetit kanë marrë emrin "Vexhi Buharaja" për nder të tij. Por, për fat të keq, emri i tij nuk përmendet në asnjë nga librat e letërsisë shqipe të shkollave të mesme. Për këtë, përveç sistemit komunist, i vihet faj dhe pasardhësve të tyre të cilëve u verbojnë disi sytë ata të cilët kanë kulturë orientale.

Padyshim, nga kontributet më të vlefshme nga Vexhi Buharaja, janë përkthimi i **"Shahname-së" dhe "Gjylistani dhe Bostani".**

Siç përmend akademiku Shefik Osmani në librin e tij **"Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë",** Shahnameja është përkthyer në shqip nga dy iranologë shqiptarë, Sheh Muharrem Mitrovica dhe Vexhi Buharaja, por në parathënien e botimit të "Shahname-së" në vitin 2001 në Tiranë, botuar nga fondacioni iranian "Saadi Shirazi", Shaban Sinani përmend se dhe para 100 vitesh, një përkthim tjetër i Shahname-së qenka bërë nga rilindësi Sami Frashëri, i cili paska mbetur në dorëshkrim dhe nuk dihet se ku gjendet tashmë. Po ashtu, edhe kryevepra tjetër e letërsisë perse, "Gjylistani dhe Bostani" është përkthyer nga dy përkthyes, dijetarë muslimanë dhe orientalistë të njohur, Hafiz Ali Korça dhe Vexhi Buharaja.

Përkthimi i parë i librit "Gjylistani" është botuar nga Hafiz Ali Korça në vitin 1925 në shtypshkronjën "Mbrothësia" që drejtohej nga Kristo P. Luarasi, por Vexhi Buharaja nuk e përmend emrin e tij.
Në veprën **"Shah name",** Firdeusi tregon në formën e poezisë epike mbi mbretërit e famshëm që kanë sunduar Persinë (Iranin e sotëm), ku më e rëndësishme aty është historia e Rustemit. Këtë epope me titull "Libri i mbretërve" ai e shkruajti gjatë sundimit të princit Mahmud, rreth një shekull pas ardhjes së Islamit në trojet e Persisë. Ajo ishte një punë kolosale e tij e shkruar brenda 30-vitesh dhe e cila më pas u bë kryevepra e letërsisë perse, tashmë gati prej 1000 shekujsh.

Për kontributet e shumanshme të orientalistit të famshëm shqiptar, Vexhi Buharaja, vetëm pas viteve '90, domethënë pas demokracisë, dhe thënë më qartë pas ndërrimit jetë të tij, vlerat e kontributeve të tij nisën të vlerësohen disi.

Më 20 dhjetor 1993 iu dha titulli "Mësues i Popullit" (post mortum) dhe Qytetar Nderi, kurse që nga data 6 korrik 1994, medreseja dhe biblioteka e qytetit të Beratit mbajnë emrin e tij.

Emri i Vexhi Buharasë përmendet gjithashtu në librin **"Antologjia e krimit komunist",** botuar në vitin 2006. Në vitin 2008, në Tiranë, u botua libri me titull: **"Vexhi Buharaja pa mite e mjegull",** shkruar nga **Yzedin Hima.** Pas një heshtje të gjatë foli edhe **Akademia e Shkencave me Fjalorin Encikopedik Shqiptar.**

Disa nga veprat shkencore e Hasan Tahsinit

Besa - dramë, Sami Frashëri
Ëndërrimet - përmbledhje poetike, Naim Frashëri
Katër Stinët - përmbledhje poetike, Naim Frashëri
Gjylistani dhe Bostani - vepër poetike, Saadi Shirazi
Shahnameja - vepër poetike, Firdeus

1 Maj 2019

Këshilla Martesore nga Prijësi i Muslimanëve

Sejjid Ali Hamenei

Paja (çejzi) e nuses

"Prestigji dhe nderimi i gruas është në moralin e saj dhe jo tek sendet e shtëpisë që përdor. Veshja e nuses nuk është arsye për t'u krenuar.

Prestigji i vajzës është në moralin e saj, në sjelljen dhe personalitetin e saj. Disa familje e ngarkojnë dhe e dëmtojnë më tepër veten e tyre. Nëse nuk i kanë mundësitë ekonomike për të bërë shpenzime e për ta stolisur e zbukuruar nusen, ata i sigurojnë me vështirësi të mëdha. Nëse kanë mundësi, ata shpenzojnë shumë për përgatitjen e sendeve të shtrenjta e të stolisura për martesën."

Imam Ali Khamenei gjithashtu "Prika e lartë dhe pajisjet e shtrenjta nuk sjellin lumturinë e asnjë vajze si dhe nuk konfirmon vazhdimësinë, qetësinë dhe besimin e kërkuar për asnjë familje, pasi këto gjëra janë margjinat e jetës dhe mbeturinat e saj. Në to nuk ka asnjë dobi, përveç lodhjeve, vështirësive dhe problemeve. Ju nuk duhet të huazoni para për të përgatitur dasmën dhe ta fusni veten dhe familjen tuaj në hall të madh. Ju nuk duhet as të mendoni se nëse mobilet tuaja nuk janë si ato të vajzës së komshiut, apo të të afërmve tuaj, kjo konsiderohet përbuzje. Kurrsesi jo! Kjo nuk është një përbuzje."

Mburrja me sendet e dasmës

Disa familje bëjnë shpenzime të rënda, bëjnë mobili të çmuara për dasmën vetëm për t'u mburrur. Kur u vjen dasma të tjerëve që nuk kanë mundësi ekonomike për të tilla shpenzime, ata futen në telashe. Deri ku do të konkurrojmë me shpenzime të tepërta për t'u mburrur? Këto janë problemet të cilat Islami nuk dëshiron t'i ketë. Gjithashtu shpesh vihet re që disa njerëz vihen në garë kur përgatisin dasmën. Ata përpiqen të bëjnë garë me të gjithë të afërmit e tyre, me komshinjtë, miqtë, të njohurit. Kjo është e gabuar. Njeriu duhet të shikojë se cila është gjëja e drejtë që duhet bërë. E drejtë është që familja e re të orientohet drejt një mënyre të thjeshtë të të jetuarit. Prandaj nuk duhen bërë shpenzime pa kriter vetëm për t'ua kaluar vajzave të tjera të njerëzve të afërt. Kjo gjë do të ishte prej gabimeve të dhimbshme dhe bezdisëse për vetë njeriun dhe për njerëzit e tjerë. Shumë prej vajzave nuk munden të bëhen nuse dhe shumë prej djemve të rinj nuk munden të martohen për shkak të pamundësive ekonomike. Nëse martesa do të ishte e lehtëdhe të rinjtë nuk do të viheshin në vështirësi, shumë probleme do të thjeshtoheshin. Vetë të rinjtë dhe prindër e tyre nuk do të ishin zemërthyer pse nuk munden t'ua plotësojnë dëshirat fëmijëve të tyre."

"Të bësh shpenzime pa kriter për dasmën për mobiliet e tjera, vetëm për të konkurruar me të tjerët, nuk është e drejtë. Kjo është vepër e gabuar dhe sjell vetëm shqetësime dhe mundime, të cilat nuk kanë asnjë shpërblim tek Allahu i Madhëruar dhe që nuk meritojnë madje as falënderim.

Kujdesi për të tjerët

Imam Sejid Ali Hamenei thotë: "Kur unë i pyes disa njerëz duke u thënë: "Kur dy persona duan të fillojnë jetën e tyre, përse e boshatisni tregun për të përgatitur mobiljet e dasmës së vajzës suaj?" Ata thonë: "Ne kemi para, prandaj e bëjmë këtë gjë!" Po a mjafton ky justifikim? Kurrsesi jo, ky justifikim është i pamjaftueshëm në mënyrë kategorike dhe është një justifikim i gabuar, sepse shoqëria përfshin të gjithë llojet e njerëzve. Ju e keni për detyrë të silleni në atë mënyrë që vajzat, të cilat nuk kanë para të mjaftueshme, të mund të martohen nëse e dëshirojnë një gjë të tillë. Në të kundërt, përgatitja që ju bëni për vajzën tuaj dhe pika që ju jepni për nusen të tjerëve, nuk janë njerëzore dhe as islame.

Paja e gruas më të mirë në botë

Imam Ali Khamenei thotë: "Shikojeni vajzën e të Dërguarit të Allahut, (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!), gruaja më e mirë e të gjitha botërave, lulja Fatime (paqja qoftë mbi të!), e cila ka qenë gruaja më e mirë prej të parëve dhe të fundit. Nuk do të vijë vajzë apo grua me këtë përsosje, me këtë fisnikëri dhe me këtë madhështi. Të gjitha gratë e botës, prej të parave deri te të fundit, para saj duken si shërbëtore apo si atome përballë Diellit vezullues. Edhe bashëkshorti i saj, prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) është burri më i mirë i universit. Edhe këtij nuk i afrohen asnjë nga burrat e botës as deri te maja e thoit.

Këto dy pejzashe të bukurisë, mirësisë dhe respektit u martuan me njëri tjetrin dhe sendet e martesës së tyre ishin vetëm pak gjëra të lira, të shkruara e të përmendura në libra. Ato ishin një copë hasër (rrogoz), një copë prej gjethe palme, një dyshek për fjetje, një katruve dhe një tenxhere. Po të mblidhen të gjitha këto dhe të vlerësohen me vlerën e sotme të parasë nuk bëjnë më shumë se disa mijëra tuman (monedhë iraniane). Ata e morën këtë prikë nga prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) dhe me to blenë sende të thjeshta dhe i dërguan në shtëpinë bashkëshortore. Ne nuk u themi sot vajzave tona që të sjellin sende dhe mobilje si ato të lules Fatime (paqja qoftë mbi të!), sepse vajzat tona nuk janë si lulja Fatime (paqja e Allahut qoftë mbi të!). Ne nuk jemi si babai i saj, (paqja qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe as bijtë tanë nuk janë si prijësi i besimtarëve (paqja qoftë mbi të!), bashkëshorti i lules Fatime (paqja qoftë mbi të!). Kush jemi ne e kush janë ata? Dallimi mes nesh dhe atyre është si dallimi i qiellit me tokën, por rruga është e njëjtë dhe orientimi është po ai. Prandaj le të jenë sendet dhe kapitulli i pestë, mobiljet tuaja të thjeshta dhe mos shikoni këtë apo atë, mos i shtoni shpenzimet dhe mos ua vështirësoni çështjen atyre që nuk i kanë mundësitë e mjaftueshme"

Dhe: "Paja e Fatime Zahrasë (paqja qoftë mbi të!) ishte në ato përmasa saqë dy persona mund t'i bartnin me duart e tyre e t'i çonin nga njëra shtëpi në tjetrën. Shikoni se me çfarë mburreshin dhe cilat ishin vlerat e tyre. A nuk kishte mundësi Pejgamberi , (paqja qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), që të merrte mobilje të mëdha? Me këtë veprim Pejgamberi, (paqja qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), dha thjesht një shembull. Myslimanët që e rrethonin atë ishin njerëz të pasur dhe i kishin mundësitë dhe kërkonin prej Allahut të Madhëruar që të vinin e t'i jepnin dhuratat e tyre Pejgamberit, (paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), apo ta ndihmonin atë.

Ata nuk e bënë këtë gjë, sepse nga shembulli i Pejgamberit, (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij!), duhej të mësonin të gjithë të tjerët. Të gjithë duhet t'i bënin të thjeshta ceremonitë.

Pengimi i zakoneve të kohës së injorancës (para Islamit)

Imam Sejid Ali Khamenei thotë:

"Mos lejoni ekzagjerimin e shpenzimeve për paisjet e dasmës. Vajzat nuk duhet ta lejojnë këtë gjë. O ju nuse, ju duhet ta sfidoni këtë gjë edhe sikur nënat dhe baballarët tuaj ta dëshirojnë. Ju mos i lejoni. Çfarë duan të bëjnë me gjithë këto sende të shtrenjta?

Gjithashtu nënat e nuseve duhet të shikojnë e të mendojnë për përgatitjen e mobiljeve të dasmës, që të mos shpenzojnë shumë e të mos e teprojnë. Ato nuk duhet të thonë se ajo është bija ime dhe se zemra e saj do të thyhej po t'i jepnim një pajë të vogël. Kurrsesi jo. Vajzat janë të mira dhe ato nuk e kanë kërkuar këtë gjë. Ne nuk duhet të krijojmë te ato mendimin se paja e shtrenjtë, e bukur dhe luksoze është domosdoshmërisht e nevojshme.

Prandaj: "Vajzat që dëshirojnë të përgatisin pajën, apo të blejnë pajisje të veçanta për ceremoninë e kurorëzimit (akdu nukah), nuk duhet të shkojnë për të blerë në dyqane që kanë çmime të larta apo në ato dyqane që nuk dua as t'ua përmend emrat. Unë e di se ku janë ato dyqane që njihen për çmimet e larta. Vajzat duhet të blejnë gjërat për pajën e tyre në dyqane me çmime të përshtatshme. Ato nuk duhet ta shoqërojnë dhëndërinë e varfër në ato dyqane të shtrenjta për të blerë sendet e dasmës, por është për të ardhur keq se ato e bëjnë një gjë të tillë.

Marrë nga Libri
Titulli: 101 këshilla për lumturinë bashkëshortore
Autori: Sejjid Ali Khmenei

Sexhdeja mbi turbe

(bisedë e pjesës)

Sami: O Ali ju shiat bëni shtrik kur bini në sexhde mbi tyrbe. A nuk është kjo tyrbe veçse suli balte e thatë të cilën ju e adhuroni atë dhe jo Allahun!

Alia: Më lejoni t'ju bëj një pyetje?

Sami: Urdhëro.

Alia: A është e obligueshme sexhdeja mbi trupin e Allahut të lartësuar?

Sami: Kjo thënie e juaj është kufër (mohim) sepse Allahu nuk ka trup, se nuk shihet me sy, se nuk preket. Dhe si i cili besoi se Allahu ka trup, ai është kafir (mohues). Prandaj sexhdeja duhet të jetë për Allahun: me kuptimin e fjalës: qëllimi i sexhdes të jetë përulje para Allahut, ndërsa sexhdeja mbi Allahun është mohim (kufër).

Alia: Me këto thënie që the del qartë se sexhdeja e janë mbi turbe nuk është shirk sepse ne bëmë në sexhde mbi turbe dhe nuk bëjmë sexhdem për turbën.
Edhe nëse besojmë se tyrbeja (balta e pjekur në formë guri) është Allahu (dhe ky është supozim i palogjikshëm) atëherë sexhdeja do ishte për të (tyrben) dhe jo mbi të.Sepse është e paimundur që një person të bie në sexhde mbi Zotin e tij.

Sami: Kjo është hera e parë kur dëgjoj përgjigje të tillë, dhe vërtetë kjo është e saktë, sepse nëse ju do ta konsideronit tyrben Allah do të bëniit sexhde për të dhe jo mbi të. Dhe sexhdeja e juaj mbi të është argument se ju nuk e konsideroni tyrben Allah.

Sami: Më lër të bëj një pyetje?

Alia: Urdhëro.

Sami: Cili është shkak i sexhdes suaj mbi tyrbe dhe pse nuk bëni sexhde mbi gjëra tjera?

Alia: Shkak i sexhdes sonë mbi tyrbe është hadithi i Profetit Muhamed s.a.s. të cilin e gjejmë në librat e hadithit të njohëshëm në përgjithësi, i cili thotë: "Toka më është bërë mua xhami dhe pastërti". Dheu i pastër dhe i papërzier është i lejueshëm për sexhde dhe të gjithë medh'hebet janë të një mendimi për këtë. Prandaj ne gjithmonë bëmë në sexhde mbi tyrben ku të gjithë myslimanët janë të një mendimi rreth saktësisë së sexhdesë mbi të.

Sami: Si janë të një mendimi myslimanët për këtë?

Alia: Kur Profeti Muhamed s.a.s. shkoi në Medina dhe ndërtoi xhamitë në të, a ka qenë xhamia e shtruar me tapihë?

Sami: Jo, nuk ka qenë e shtruar me tapeta.

Alia: Mbi çfarë ka pas rënë në sexhde Profeti?

Sami: Mbi Tokë.

Alia: Pra në të gjitha namazet, Profeti s.a.s. ka rënë në sexhde mbi tokë dhe po kështu myslimanët në kohën e tij dhe pas tij dhe kjo sexhde mbi tokë është e saktë dhe ne kur bëjmë sexhde mbi tyrbe zbatojmë vepromin e profetit Muhamed s.a.s.

Sami: Pse bëni sexhde vetëm mbi atë copë guri apo qerpiçi të cilin e mbani me vete dhe nuk bëni sexhde mbi pjesët tjera të tokës?

Alia: Ne pari shiat e lejojnë sexhden mbi të gjitha pjesët e dheut qofë e ngurtësuar apo jo. Se dyti, përderisa është krubit që vendi i sexhdes të jetë i pastër, pra nuk ishte e lejueshme sexhdeja mbi tokën e ndytë për këtë ne mbajmë me vete një copë balte të thatë dhe të pastër, për të qenë sigurt për sexhdesë. Sa për dëjeni ne e lejojmë sexhden mbi dhe dhe apo mbi tokën ku nuk e dinë se është e ndyrë.

Sami: Nëse ju e lejoni sexhdenë mbi dheun pluhur, atëherë përse nuk mbani me vete pluhur për të bërë sexhden?

Alia: Përderisa dheu pluhur i bën pis rrobat, për këtë arsye ne e përzjemë me pak një pastaj e lemë të thahet, derisa mbajtja e tij nuk i bën pis rrobat. Pastaj sexhdeja mbi atë copë të thatë balte është fakt i përuljes ndaj

Allhut të lartësuar, sepse qëllimi i sexhdes është përulje para Allahut, prandaj nuk është e lejueshme që sexhdeja të jetë për diçka tjetër veçse për Allahun. Për këtë është e preferuar që vendi i sexhdesë të jetë më i ulët se ai i duarve dhe i këmbëve, sepse ky është argument rreth përuljes për Allahun. Po ashtu është mirë që maja e hundës të vendoset mbi tokë në kohën e sexhdes si përulje para Allahut. Pra sexhdeja mbi tokë apo mbi një copë balte të thatë (turbet) është më e mirë se sa sexhdeja mbi gjërat e tjera, sepse në sexhden mbi tokë vendosim pjesën më të ndershme të trupit të njeriut i cili është balli gjë e cila tregon përulje dhe zvogëlim para madhështisë së Allahut të lartësuar.

Ndërsa, kur njeriu e vendos ballin e tij gjatë sexhdes mbi tapetin e shtrenjtë apo mbi argjend, flori, akika gurë të çmuar e tjerë, apo mbi rrobat me vlerë të lartë, ky veprim e pakëson përuljen dhe nënshtrimin para Allahut, dhe ndoshta të çon në mos zvogëlim para Madhështisë së Tij (xhsh).
Pra, a mund të konsiderohet sexhdeja mbi ato gjëra të cilat i shtojnë njeriut përulje dhe nënshtrim para Zotit të tij, shirk apo kufër (mohim), dhe sexhden mbi ato gjëra ku nuk gjindet shtesë në përulje për Zotin ta quajmë afrim tek Allahu? Ato thënie nuk janë veçse shpifje.

Sami: Çfarë janë ato fjalë që gjinden mbi turbetin?
Aliu: Jo në të gjitha ttrbet gjendet shkrimi sepse ka shumë tyrbe mbi të cilat nuk gjendet shkrim. Së dyti: Shkrimi që gjindet mbi disa tyrbe e ka kuptimin se ky tyrbet është marrë nga dheu i Qerbelasë së bekuar. A gjendet shirk në të apo a e anulon ky shkrim qënien e tyrbetit prej dheu të lejueshëm për sexhde? Jo.

Sami: Cila është ajo veçanti e turbetit të tokës së Kerbelasë, ku shohim se shumica e shijave e kryejnë sexhden mbi të?

Aliu: Shkaku qëndron se gjindet hadith i cili thotë "Sexhdeja mbi turbetin e Imam Husejnit (dheut të Kerbelasë) i hap shtatë qiejt".

Pra ky hadith ka kuptimin se sexhdeja mbi turben e bën namazin të pranueshëm dhe ngritjen e tij në qiej.

Sami: Po nëse namazi nuk është i rregullt a e bën sexhdeja mbi tyrben të pranueshëm?

Aliu: Shiat thonë se, nëse namazi i cili nuk falet në bazë të kushteve që e bëjnë atë të saktë ky namaz është i papranueshëm. Por ai namaz në të cilin gjendet të gjitha kushtet që e bëjnë atë të saktë ky namaz është i pranueshëm tek Allahu i Lartësuar ose mund të jetë i pa pranueshëm, pra nuk merr shpërblim prej tij. Nëqoftëse namazi është i rregullt mbi turben e Husejnit paqja qoftë mbi të, ai është i pranueshëm dhe i shpërblyeshëm. Por mos harrojmë se pranimi është gjë dhe të jetë i rregullt është gjë tjetër.

Sami: A është toka e kerbelasë më e bekuar se e gjithë toka e rruzullit tokësor? Më e bekuar se toka e Mekes dhe Medines, ku sexhdeja mbi të është e përsosur?
Aliu: Nuk ka asnjë dallim në to.

Sami: Si ka mundësi që toka e Mekës e cila gjendet që prej zbritjes së Ademit a.a. në tokën e Qabes, dhe tokën e Medines e cila mban trupin e Profetit të Madh s.a.a. të jenë jo në atë pozitë siç është toka e Kerbelasë? Kjo është e çuditshme! A është Hysejn ibën Ali më i përsosur se gjyshi i tij Profet Muhamedi s.a.a.?

Aliu: Jo. Madhështia e Hysejnit është pjesë e madhështisë së Profetit s.a.a. Nderimi i Husejnit është pjesa e nderimit të Profetit s.a.a vendi e Husejn tek Allahu i Lartësuar është se ai është imam dhe ndoqi fën e gjyshit të tij Profetit Muhamedit derisa ra dëshmor. Por pozita e Husejnit nuk është veçse një pjesë e pozitës së Profetit s.a.a. Derisa Husejni, së bashku me familjen e tij dhe shokët e tij u vranë në rrugën e përhapjes së Islamit dhe forcimin e bazave të tij, dhe për mbrojtjen e fesë prej duarve të ndjekësve të lakmive, Allahu si pasojë të kësaj i ka dhënë dy gjëra shpërblyese:

- Duaja është e pranueshme pranë mezarit të tij.
- Shërim në tyrben e tij.

Allahu e ka madhëruar tyrben e Husejnit sepse ai u vra në rrugën e Allahut në mënyrat më barbare. Gratë e tij u morën robëresha, shokët e tij u vranë, e të tjera fatkeqësia dhe të gjitha këto në emër të fesë. Apo, përparësia dhe favorizimi i tokës së Qerbelasë mbi të gjithë tokat e rruzullit, deri edhe tokën e Medines, nuk do të thotë kjo se Husejni është më i përsosur se Profeti Muhamedi?
Por përkundrazi: Ajo është madhështia për Hysejnin, dhe madhështia e Hysejnit është madhështia për Allahun dhe Profetin s.a.a.

Sami: Kjo është e drejtë, unë përfytyroja se ju thoni se Husejni është më i përsosur se Profeti s.a.a. dhe tani e mësova të vërtetën.

Unë të falenderoj ty për këto sqarime të drejta, dhe gjithmonë do të mbaj me vete në copë prej dheut të kerbelasë së bekuar për të rënë në sexhde mbi të kudo që të falem dhe do ta mënjanoj sexhden mbi tapete, etj.

Aliu: Unë desha të sqaroj se ato akuza të drejtuara mbi ne shiat nuk janë të vërteta, por ata janë shpifje dhe gënjeshtra të cilat I sollën armiqtë e islamit dhe të myslimanëve për qëllim përçarje. Dhe mos u kujdes për ato që dëgjon kundra shiave pa bërë kërkime dhe studime rreth realitetit dhe të vërtetës.

Përktheu redaksia VLERA.

Lufta e Qerbelasë

dhe rrëfimi i pas Qerbelasë në "Myhtar Name"

Lufta e Qerbelasë dhe rrëfimi i pas Qerbelasë në "Myhtarname" Lufta e Qerbelasë konsiderohet një nga ngjarjet më të dhimbshme në të gjithë historinë e Islamit. Kujtimi i saj qëndron gjithmonë i paharruar në mendjet e gjithë besimtarëve të botës islame. Po, cila është kjo ngjarje dhe cilët janë personazhet e saj? Cilat ishin synimet e vërteta të atyre që e planifikuan atë?
Në ditët e para të Hënës Muharem të vitin 63 të Hixhretit (Kalendari Islam), Imam Hysejn ibn Aliu së bashku me familjen e tij gjatë udhëtimit për në Qofe (Kuffe) rrethohet në fushën e Qerbelasë nga ushtria e Jezid ibn Muavijes dhe në mes të një lufte të pabarabartë e për vetëmbrojtje, masakrohet brutalisht me fëmijët dhe rrethin e tij që e shoqëronte. Prapaskena e kësaj tragjedie padyshim ishte uzurpimi me dhunë i halifatit në dëm të së drejtës legjitime. Kjo pabesi e rëndë ndaj familjes të Resulullahut në fund të fundit do të kulmonte atë kontradiktë të thellë që ekzistonte mes fiseve Hashimij dhe Umeje, shkak i të cilës u bë fillimisht e drejta mbi shërbimin në faltoren e Qabes. Kjo armiqësi e akumuluar ndër vite nxori kokë gjatë periudhës së vahjit, ku siç dihet i Dërguari i Zotit në misionin e tij për përhapjen e islamit u përball me vështirësi të shumta dhe reagime të forta kundërshtarësh. Por gradualisht besimi islami u përqafua thuajse nga të gjithë, veç disa emrave që ngelën në histori si sinIonim i së keqes, Ebu Lehebi, Ebu Sufjani që ishte i ati Muaviut dhe gjyshi i Jezidit, femohues i vendosur deri në fund të jetës së tij etj.

Me helmimin e Imam Hasanit dhe pas tij, vrasjen mizore të Imam Hysejnit, u hap rruga për ardhjen në fuqi të dinastisë një shekullore të Emevive, një prej dinastive më gjakatare dhe të shthurura në botën arabe. Jezid ibn Muaviju që pretendonte padrejtësisht Halifatin, filloi të zgjeronte influencën në të gjithë vendet arabe me anë të forcës dhe intrigës, ashtu siç bëri i ati i tij Muaviu, kur ishte gurvenator i Shamit. Në mesin e atyre të paktë personave me influencë që u përpoqën të ndalnin synimet djallëzore të tij ishte dhe Imam Hysejni. Vrasja e Imamit ishte e vetmja rrugëzgjidhje për Jezidin, për të marrë dhe siguruar fronin. Ashtu siç rrëfehet nga historia e Islamit, gjatë udhëtimit nga Qabeja në Kufe, karvani me familjarë dhe rrethin e ngushtë shoqëror të Imam Hyjsenit rrethohen në Qerbela, ku në mesin e nxehtësisë dhe etjes për ujë, vriten mizorisht 72 burra, që njihen në histori si dëshmorët e Qerbelasë.

Prej kësaj masakre mbi nipin e shenjtë të Profetit Muhamed shpëtuan mrekullisht vetëm gratë dhe një nga djemtë e Imam Hyjsenit, Imam Zejnel Abedini, që ishte vazhduesi legjitim i traditës së familjes profetike. Përmendëm disa detaje të rëndësishme nga kjo betejë, që është një ndër ngjarjet që ka ngjallur shumë debate e interpretime ndër historianë të ndryshëm, për të treguar qëllimin e vjershërimit që bëri poeti i rrymës letrare të bejtexhinjve në Shqipëri, Shahin Bej Frashëri. Kjo na sjellë një vazhdim të historisë pas Qerbelasë, " Muhtar - name " me në qendër njërin prej personazheve kryesorë të asaj periudhe, Myhtar bin Ubejde, prej të cilit edhe është frymëzuar për t'i vënë titullin poemës :
O Myhtar të qofsha falë, si lulëkuq shkove dhe tinë,
E ke kënaqur Xhemalë, për Imam Hysejn Alinë !
Përveç vlerave historike, edukative fetare që ka, duhet theksuar që ky vjershërim ka rëndësi edhe në aspektin gjuhësor, sepse tregon përpjekjet e autorëve të asaj kohe, për të shkruar në shqip, në mungesë të një alfabeti zyrtar. Në këtë botim vepra vjen e rivargëzuar nga Shefqet Bajo, siç sqaron dhe ai vetë në hyrje të poemës :

O Engjëll krahë zjarrtë, që vjen duke fluturuar,
Më trego Zoti të faltë, a Zoti madh të ka dërguar ?

Kam patur shumë nevojë, natë e ditë të kam pritur,
Se pa ty s'po hap dot gojë, për këtë vepër të ndritur.

Të filloj Myhtar - Namenë, rishtazi për t'a vjershuar,
Të trimit që tundi dhenë, Myhtar - Gaziut të lëvduar.

Ndihmomë mua të varfërin për këtë vepër të lartë,
Të Shahin Bej Frashërit, pastë ndjesë dhe lëvdatë.

Ashtu siç mësojmë nga vetë autori, ky është libri i katërt i vjershëruar prej tij: Librat që kam vjershuar, nga proza që kanë qenë, Ky mundim qoftë i pranuar, me këtë katër u bënë.
E para Vilajet - Nameja, e dyta Eba Myslimi, e treta Hysnijeja, e katërta Myhtar-Trimi !
Vepra nis me parathënien e Shahin bej Frashërit, ku autori kërkon ndjesë dhe për ndonjë gabim në përkthim. Poema fillimisht ka qenë në gjuhën perse, më pas është përkthyer në turqisht : Kështu vazhdoi disa kohë, sa u përkthye turqisht, Loti më kullon si llohë, duke shkruar shqipërisht.

Pjesë e marrë nga Libri "Myhtar Name", Urtësia Bektashian Tiranë 2014.

KUSH ËSHTË

Fatime Zehra?

Shpesh ulem dhe mendohem e pzes veten a thua kush ishte Fatime Zehra ?!

A ishte sikur qielli i qetë natën i mbuluar me yje vezulluese, apo si drita e shkelqyer e hënës, apo mos vallë si uji i kthjellët kur del prej maleve të larta.

Ajo është mbi të gjitha çiltërsitë që Allahu i ka krijuar është mbretëresha e bukurive. Është grua mbi të gjitha gratë, ajo është me shumë virtyte dhe karaktere të shumta është e pastërt e mbrojtur nga zjarri, e sinqertë, ndriçuese, e bekuar, e urtë, është personi i cili kontakton me melekët, ajo është mrekullia e Allahut të cilën e dërgoi në këtë botë së bashku me suren Kevther, si shembull për të gjitha gratë muslimane. Që nga ajo kohë e deri më sot, Fatimja mbeti simbol i të gjitha virtyteve që mund të i ketë një femër e cila ishte e edukuar nga babai i saj Pejgamber.

Oj nënë e madhe- nënë e myslimanëve, përkundrazi, dhimbjeve, mjerimeve, vuajtjeve dhe shqetësimeve qe i ke pasur në jetën tënde ne të kemi pasqyrë e vlerave të pastërta që na dhe.

Ja pra kjo është FATIME ZEHRA.

Jeta Ismajli- Prishtinë.

Këshilla psikolo

ÇFARË MUND TË BËJ ME FËMIJËN TIM

Shikoji dhe lexoji libra e tyre e pastaj i bashkëbisedo për ato.

Mësoj vjersha në gjuhën amtare, tregime, këngë dhe përralla

Tregoj për farefisin për vendlindjen dhe për gjërat që kanë ndodhur në të kaluarën

Bisedo për ndodhitë e ditës hobit dhe për shokët e fëmijës.

Dërgo fëmijën që të vizitoj vende të ndryshme: në muze, qytet, fshat, kopsht zoologjik, bibliotekë etj.

Punët shtëpiake, p. sh përgatitni ushqim, gatuani ose edhe pastroni së bashku

Ushtroj talentin e dorës, p. sh mbajtjen e lapsit në dorë dhe përdorimin e gërshërëve

Gjithashtu bisedo me fëmijën për të gjitha çfarë bëni dhe çfarë po shihni, kështu fëmija vazhdimisht mëson gjëra dhe fjalë të reja

NË ÇFARË MËNYRE BABAI MERR PJESË NË EDUKIM

Kalo kohën me fëmijën duke luajtur, duke i mësuar gjëra dhe tregime të ndryshme

Ndihmo në kryerjen e detyrave dhe e mbikëqyrë

vijimin e mësimit.

Përcjelli dhe merr pjesë në hobit e ndryshëm të fëmijës

Ndaji punët barabartë me gruan

Jepi mundësi që edhe gruaja të ketë kohë për vetveten

SI MUND TI NDIHMOJ FËMIUT TIM

Dërgo fëmijën në vende ku ka fëmijë tjerë.

Jepi kohë ,vend dhe mundësi të luaj.

Mëso fëmijën të pret në radhë dhe ti shkëmbej
lodrat me të tjerët

Foli nëse fëmija sillet në mënyrë agresive apo i ngacmon të tjerët

Mëso fëmijën të shpreh me fjalë hidhërimin dhe dëshpërimin

gjike për prindër

SI TË NDIHMOHET FËMIJA GJATË SHKOLLIMIT

Rregulloja fëmijës tavolinën e punës të përshtatshme që ti kryej detyrat e shtëpisë.

Pyet çdo ditë çka keni mësuar në shkollë si dhe çfarë ka ndodhë gjatë pushimeve.

Kontrollo a janë kryer detyrat; kërko nga fëmija të tregoj se çka ka mësuar

Nëse nuk mundesh ta ndihmosh fëmijën me detyrat, kërko ndihmë nga prindërit tjerë

Krijo rrethin që të ndihmon për ti zgjidhë këto detyra

Kontakto vazhdimisht me mësuesin gjithashtu merr pjesë në mbledhjet e prindërve.

SI TA NDIHMOJMË TË RIUN TË RRITET

Jepi urdhër të qartë p.sh. për kohën kur duhet të kthehet në shtëpi, për mos përdorimin e drogave etj.

Trego, argumento cilat veprime janë të drejta dhe cilat jo.

Bisedo shpesh si është, si kalon në shkollë dhe me shokë.

Bisedo në lidhje me moshën e pubertetit p.sh mund të tregosh përvojat tuaja të rinisë

Ju duhet të jeni të njoftuar çfarë është jeta e të rinjve në Kosovë

Bisedoni së bashku se çfarë mendon të bëjë kur te kryhet shkolla, cili profesion mund te jetë i përshtatshëm për të ardhmen.

Bisedo edhe me prindërit tjerë për rritjen e zhvillimin e të rinjve në Kosovë.

Përgatiti Msc. Psikologu, Petrit Thaqi.

Thënje të urta nga
Naim Frashëri

Kombin shumë ta doni
E si fëmijë ta kini
Me të drejtë të gjykoni
E çdo punëzë ta dini.

Cherish the nation dearly,
As if it were a child
Judge it with justice
And know every ken.

Ai që me brumin e vuajtjes u gatua
Zemrës, shpresë dhe durim iu dhurua.

The one who rose out of the ashes of affliction
His heart, has been granted hope and patience.

Gjithë gjuhët t'i mësoni
Po shqipen mos e lini
Mirësitë e Shqipërisë
I mbani, mos i harroni .

Within the languages you learn
Don't leave the Albanian
The prosperities of Albania
Cherish them, remember them.

Nëse nuk e donë njeriun, s'je njeri
Shpirti, zemra s'konë vlerë pa dëlirësi.

If you don't love the man, you aren't a human being
The heart and the soul is nothing without purity.

Mësoni fëmijët të dinë më shumë se ju,
se ata janë për një kohë më larg nga ju.

Teach your child to know more than you do,
because they are for a time farther away than you.

S'ka në jetë njeri më të ligë se tradhtari i kombit dhe i mëmëdheut.

There is no one more wicked than the traitor of nation and the motherland.

Për të korrur duhet mbjellur, për të trashëguar duhet punuar.

To collect harvest you must plant, to inherit you must labor

Një vepër e mirë e prindërve, vlen më shumë sesa një mijë fjalë të tyre.

A good deed done by parents is worth more than a thousand words.

Sa e vlerësoni kombin tuaj, aq ju vlerëson dhe një i huaj.

The more you praise your nation, the more a foreigner appreciates you.

Sytë e përlotur

Asnjëherë nuk e harroj. Para disa viteve kur isha në klasën e tretë dhe me shokët luaja futboll, një nga fëmijët thërriti me zë të lartë nga një rrugicë: Fëmijë! Ka humbur një fëmijë i vogël dhe është duke qarë! E ndërpremë lojën dhe të gjithë së bashku shkuam pranë saj. Pamë një vajzë të vogël që kishte flokë të zeza e të bëra gërshet dhe sytë iu ishin skuqur nga të qarët e shumtë. Ajo ishte e lodhur vetëm përsëriste fjalët: " Nëna, nëna ime ku është?" Unë thashë: "Ta dërgojmë atë në një xhami që me anë të atropolantit nga minarja ta shqiptojnë emrin e saj dhe ndoshta prindërit e saj mund të gjenden". Fëmijët e pranuan mendimin tim dhe të gjithë së bashku shkuam në drejtim të xhamisë. Gjatë rrugës, njëri prej fëmijëve i bleu akullore vajzës së vogël, por ajo nuk e pranoi akulloren dhe duke qarë tha: " Unë dëshiroj nënën time!". Me shumë vështirësi e kuptova që vajza e vogël quhej Merjeme.

Shërbëtori i vjetër i xhamisë me anë të mikrofonit disa herë tha: "Është gjetur një vajzë e vogël me emrin Merjem. Luten prindërit që sa më parë të vijnë në xhami". Vajza e vogël qante dhe kërkonte nënën e vet, dhe në fund ajo e ndërpreu të qarët sepse nëna e saj i erdhi! Vajza vrapoi në drejtim të nënës dhe u qetësua ku e përqafoi atë.

Edhe ne gjithashtu jemi si ky fëmijë i vogël dhe gjatë gjithë jetës shkojmë pas një njeriu apo gjësendi që të gjejmë qetësi. Ajo gjë nuk mund të jetë paraja, pozita, forca, bukuria apo gjëra të tjera materiale. Sepse, një pjesë e njerëzve i posedojnë këto gjëra, por prapëseprapë nuk kanë qetësi dhe gjithnjë janë të shqetësuar e të brengosur. Në Kur'anin e Madhëruar thuhet: "Ata që besuan dhe me të përmendur Allahun, zemrat e tyre qetësohen, pra ta dini se me të përmendur Allahun zemrat qetësohen". Dhe, namazi është rruga më e mirë për të arritur qetësi.

Falje të namazit

njohuri për fëmijë.

Veprimi i parë për të falur namazin është marrja e abdesit. Imam Bakir (a.s.) ka thënë:

"Namazi pa abdes, nuk është namaz"

Rroba të bukura

Në kohën kur Imam Hasani (as) dëshironte të falte namazin, i vishte rrobat më të bukura. E pyetën atë: **"Pse gjatë faljes namazit i vishni rrobat më të bukura?"**. Imami u përgjigj: **"Zoti është i bukur dhe e do bukurinë. Për këtë arsye, unë i veshi rrobat më të bukura kur falem dhe i lutem Zotit".**

Gjatë faljes së namazit rrobat e falësit duhet të jenë t pastra dhe hallall, është e preferuar që rrobat të jenë me ngjyrë të bardhë dhe të pastër si dhe të kenë erë të mirë.

Yjet mbi tokë

Gjatë faljes së namazit, vendi i faljes së namazit duhet ët jetë i pastër dhe hallall. Vendi më i preferuar për të falur namazin është xhamia. I Dërguari i Allahut (saa) ka thënë: "Xhamitë janë shtëpitë e Zotit mbi tokë. Ashtu sikur yjet janë ndriçues për banorët e tokës, ashtu edhe xhamitë janë ndriçues për banorët e qiellit".

Shikimi domethënës

Personi i cili falet duhet të drejtohet kah Qabeja. Qabeja është sekreti i unitetit të myslimanëve. Kur të gjithë myslimanët e rruzullit tokësor drejtohen nga Qabeja, atëherë krijohet një pamje e bukur. Qabeja e madhëruar është shtëpia e cila ndodhet në qytetin e Mekes.

Në fillim të Islamit, kur i Dërguari i Allahut (saa) nuk ishte shpërngulur ende në Medine, trembëdhjetë vite të tëra e falte namazin në drejtim të Bejtul Mukadesit. Pas shpërnguljes në qytetin e Medinës, populli jehud filloi që t'i ngacmonte myslimanët dhe duke i përqeshur atyre u

thoshin: "Në qoftë se feja e Muhamedit është fe e ndarë në vete, atëherë përse nuk posedon një Qabe të ndarë, por e falë namazin në drejtim të Qabesë sonë (Bejtul Mukadesit)?" Këto thënie shqetësuan pa masë zemrën e pastër të Dërguarit (saa).

I Dërguari i Allahut (saa) në mes të natës zgjohej nga gjumi, dilte jashtë nga shtëpia dhe shikonte drejt qiellit të natës. Ai ishte në pritje të shpalljes së Zotit. Një natë zbriti ajeti nga ana e Zotit xh.sh.:

Në vitin e parë të shpërnguljes, i Dërguari i Allahut (saa) me anë të festës së Ummi Besherit kishte shkuar në mes fisit Beni Salim në pjesën perëndimore të qytetit të Medinës. Në kohën kur i kishte falur dy rekatet e para të namazit të drekës në drejtim të Bejtul Mukadesit (Qabesë së parë), zbriti urdhri i Zotit për t'u kthyer në drejtim të Qabes. I Dërguari i Allahut (saa) pjesën tjetër të namazit e fali në drejtim të Qabesë dhe që nga ajo kohë ajo u bë kibleja e përhershme e myslimanëve.



10 këshilla profesionale

SE SI TË LYENI DHOMËN TUAJ

Ngjyrosja e dhomës mund të jetë mundësi e mirë e kalimit të kohës në fundjavë. Eshtë projekt me kosto të ulët, nuk është aktivitet dhe aq I vështirë dhe në qoftëse bëni gabime gjatë ngjyrosjes, gabimet lehtësisht përmirësohen. Mirëpo, para se të merrni ngjyrën dhe brushat, duhet bërë një plan paraprak.
Më poshtë mund të lexoni hapat që duhet marrur për t'u siguruar që projekti juaj do të jetë I suksesshëm.

1. FILLONI ME PLANIFIKIM

Filloni duke menduar se si do të duket dhoma juaj e përfunduar dhe mos harroni se nuk jeni të limituar në katër mure me të njejtën ngjyrë. Konsideroni të ngjyrosni njërin nga muret me ndonjë nuancë më të theksuar. Mos harroni të shikoni se a ka nevojë për një rifreskim tavani gjithashtu!

2. ZGJEDHNI NGJYRËN TUAJ

Shfletimi I katalogëve të ngjyrave mund të jetë lodhës pasiqë do të gjeni vetën duke mos zgjedhur asgjë në mesin e tërë atyrë zgjedhjeve. Filloni duke vendosur se a dëshironi të merrni nuanca të ngrohtë apo të ftohtë. Hije neutrale apo të ngopur? Pasi të keni vendosur, merrni disa mostra dhe testoni per të parë se si duken në dhome në kohë të ndryshme të ditës. Shume kompani të bojrave gjithashtu kanë dhe websitet e tyre ku ju mund t'I shfletoni ngjyrat.

3. ZGJEDHNI MJETET DHE MATERIALET TUAJA

Çdo projekt është unik dhe mund të keni nevojë për mjete të ndryshme në varësi të bojës që zgjidhni dhe gjendjes së mureve tuaja, por ka disa gjëra që duhet të keni patjetër:
Ngjyrë, brusha apo roller, shtylla zgjatëse e rollerit, tabakun për ngjyrosje, material për mbulimin e hapësirës, letër grithëse dhe ngjitës për detajet në mur.

4. PËRCAKTONI SA NGJYRË DO T'JU DUHET

Një rregull e përgjithshme thotë se 1 litër ngjyrë mund të mbulojë rreth 6.5 m 2 të murit. Por ky është vetëm një udhëzim I përafërt. Ne internet mund të gjeni kalkulatorë të ndryshëm të cilët saktësojnë

sasinë e nevojshme të ngjyrës e cila do t'ju duhet juve. Nëse po planifikoni të zbadhni një mur me ngjyrë të errët do të ju duhet ngjyrë shtesë për arsye se do të duhet të lyeni më shume shtresa me ngjyrë krahasuar me muret me ngjyrë të çelët. Sugjerohet blejra e rreth 10% më shumë boje se sasia e llogaritur.



5. PËRGATITNI MURET DHE DHOMËN

Së pari zbrazni dhomën nga të gjitha mobiljet. Nëse nuk keni hapësirë të mjaftueshme, shtyni gjithçka për në qendër. Mbuloni pjesët me çarçafë plastike dhe bëni të njejtën me dyshemenë. Kjo këshillë është më se me rëndësi pasiqë ngjyra do të pikojë patjetër në dysheme. Merrni ngjitës letre dhe vendoseni në skajet e dhomës, kornizave të dritareve, dyerve dhe prizave.

6. PËRZIENI BOJËN TUAJ

Përdorni një shkop druri për përzierjen e bojës dhe përsëriteni shpesh gjatë gjithë lyerjes. Nëse përdorni më shume se 4 litra ngjyrë, kombinoni kanaçet në një kovë të madhe në rast se ka ndonjë ndryshim të lehtë të ngjyrës.

7. ZGJEDHNI TEKNIKAT TUAJA TË LYERJËS

Boja juaj është përzier dhe brushat janë gati, por sigurohuni që të planifikoni një strategji para se të filloni. Punoni nga pjesët e larta të dhomës duke filluar nga tavanet. Trajtoni muret me radhë. Lyeni vendet kritike fillimisht. Kur jeni duke lyer me roller, bëni lëvizjet në formen W për t'ju shmangur shenjave bezdisëse. Sapo muri të thahet në prekje, është gati për një shtresë të dytë.

8. MOS HARRONI VENTILIMIN

Sigurohuni që hapësira juaj të jetë e ajrosur mirë gjatë gjithë lyerjes duke hapur dritare dhe duke përdorur ventilator. Hapesira duhet të jetë e ngrohtë gjithashtu që procesi I terjes të jetë sa me I shpejtë.`

9. PASTRONI PAJISJET

Pasi të keni përfunduar lyerjen me bojë, mos harroni të pastroni vendin dhe pajisjet pasiqë ato mund të ripërdoren dhe herën tjetër. Shumica e brushave, të cilat kane ngjyrë me bazë uji, mund të pastrohen edhe vetem me sapun, kurse ato me baze vaji, kanë nevojë për tretës të veçantë.

10. JEPINI VETËS KOHË TË MJAFTUESHME

Koha që projekti juaj do të marrë varet nga madhësia e dhomës tuaj, mënyra se si lyeni muret dhe aftësitë tuaja. Lyerja e mureve me pigmente më të mbyllta dhe lyerja e tavanit do të marrin më shumë kohë sesa lyerja e mureve të dhomës me një ngjyrë neutrale. Disa hapësira mund të kryhen për disa orë, ndërsa të tjerat mund të zgjasin për disa ditë. Sigurohuni të keni kohë në dispozicion dhe mos harroni të merrni parasysh përgatitjen dhe pastrimin pas perfundimit të punimeve.

REVISTA VLERA